



# DRITA ISLAME

Botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë / Çmimi: 250 Lekë / [www.dritaislame.al](http://www.dritaislame.al)

Viti XXXIV / Nr. 09 / Shtator 2025



Morali dhe  
universalizmi i

**Profetit  
Muhammed**



**“DRITA ISLAME”**

**Botim i Komunitetit Mysliman  
të Shqipërisë**

**www.dritaislame.al**

**DREJTOR**

**Dorian Demetja**

**KRYEREDAKTOR**

**Mehmet Disha**

**DIZAJNI DHE FAQOSJA**

**Erzen Carja**

**KONTAKT:**

**Tel/fax +355 68 87 71 655**

**E-mail: mehmet.disha@kmsb.al**


**Viti XXXIV i botimit**

**Nr. 09 (508)**


**Shtator, 2025**

**ISSN 2226-7115**

*Artikujt  
që vijnë në redaksi  
dhe botohen, nuk  
paraqesin domosdoshmërisht  
edhe pikëpamjet e revistës.*



**www.dritaislame.al**



## editorial

**04** Ç'premtion besimi?  
Mehmet Disha

## në fokus

**08** Morali dhe universalizmi i Profetit Muhamed a.s.  
H. Bujar Spahiu

**10** Ardhja e Krenarisë së njerëzimit (s.a.s.)  
Elton Karaj

## lajme / aktivitete

**12** 01-Çelet viti i ri akademik 2025-2026 në të gjithë vendin  
02-Program fetar kushtuar Profetit Muhamed (a.s) (mevludi) në xhaminë Et'hem Beu  
03-Sesioni i tretë i trajnimit shkencor-fetar për imamët dhe hatibët në Shqipëri  
04-Një grup prej 27 intelektualësh gjermanë vizitojnë KMSH-në  
05-KMSH nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me qendrën e formimit profesional

## refleksione

**18** Kur natyra ankohet  
Feim Hoxha

## çështje fetare

**20** Qëndrimi Islam ndaj ndërhyrjeve estetike dhe kirurgjikale  
Këshilli për Çështjet Fetare – insi.al

## familja

**22** Stilet e prindërimit, si ndikojnë tek fëmijët  
Redaksia

## horizonti i besimit

**24** Deklaratë e përbashkët për Palestinën  
KNFSH

**26** Frika nga librat  
Husejin Elmas

**28** Nepotizmi në Administratë dhe  
Hz. Ijad Ibn Ganm r.a / Tauland Bica

**32** Fragmente nga kumtimi i Profetit Muhamed a.s.  
Dorian Demetja

## bota shpirtërore


**34** Ankimi si mënyrë të menduari  
Islam Hoxha

## hapësirë femënore

**36** Dashuria e vërtetë  
Hapësirë Femënore

## këndi i poezisë

**38** Qabja e madhnueshme  
Hafiz Ibrahim Dalliu



# Ç'premtion besimi?





Deri më sot janë thënë shumë gjëra në lidhje me bukuritë që besimi i fal njeriut, qoftë gjatë kësaj jete, qoftë gjatë asaj tjetrës, duke qëndruar gjerë e gjatë në të gjitha çështjet që i prijnë qenies njerëzore drejt shpëtimit. E nëse do të hidhet një vështrim mbi të gjitha këto, ka për t'u kuptuar se si besimi i përfiton njeriut një këndvështrim më të thellë e më të gjerë, i cili i shërben atij për ta lexuar dhe vlerësuar më mirë jetën. Për shembull, kur e sheh gjithësinë një njeri që beson, atij çdo gjë brenda saj i duket nga një mik dhe bashkudhëtar i përzemërt. Asisoj që ai nuk e përjeton asnjëherë kurbetin e rrugëtimit pa një bashkudhëtar me vete. Njëkohësisht, vetëm falë dritës që ai i përfiton jetës në sajë të këtij besimi, ai zë ta shohë të ndriçuar, si të shkuarën ashtu edhe të ardhmen; sepse sipas tij, as e shkuara nuk është një varrezë e frikshme, e as e ardhmja një gropë varri sterrë e zezë.

Patjetër, është e natyrshme që njeriu të ndjejë frikë dhe shqetësime nga më të ndryshmet në lidhje me të ardhmen, mirëpo drita dhe shpresa që besimi i fal atij, e ndihmon që t'i flakë tej të gjitha këto frikëra. Tevona, një njeri që e ka të ngulitur besimin e tij në themele të shëndosha, e kupton mjaft mirë se asnjë prej këtyre frikërave nuk është ndonjë gjë për të cilën nuk gjendet një zgjidhje, e kësodore ai gjen mundësi që të largohet prej këtyre vuajtjeve dhe dhimbjeve sakaq. Mos vallë ka frikë prej errësirës së botës së varrit dhe jetës së atjeshme? Besimi për të fillon të kryejë funksionin e një drite. Mos vallë ka frikë nëse do të mund ta kalojë dot urën e Siratit? Besimi për të kthehet në Burak, me të cilin ai arrin ta kalojë atë fluturimthi. Mos vallë shqetësohet për përfundimin e tij? Besimi për të është rruga më e sigurt që të çon drejt Xhenetit. Mos vallë i frikësohet shumë fundit të tij? Besimi për të është streha më e mirë për t'u mbrojtur prej Xhehenemit. Po, në këtë rrugëtim të gjatë që ka nisur, besimi për njeriun është sikur një udhërrëfyes dhe mësues që i qëndron përherë në të majtë dhe në të djathtë, për t'i falur siguri dhe besim për çdo gjë që mund t'i bëjë gjasë në të ardhmen.

### **E vërteta e vdekjes**

Besimi mbart brenda vetes një farë shpirtërore të pemës së Xhenetit. Besimtari

gjatë gjithë kësaj jete jeton një jetë tejet të paqtë. Sepse në sajë të besimit që ka në zemër, ai ka shpëtuar prej frikës së kalbjes deri në zhdukjen në hiçmosgjë. Le të thotë ç'të dojë ndonjëri, e kush të dojë le t'i afrohet si të dojë kësaj çështjeje, e vërteta është se mohuesi, pra mosbesimtari, e ka të pamundur që t'i shmangë apo fshijë nga mendja apo zemra shqetësimet që lidhen me zhdukjen përfundimtare pas vdekjes. Madje këto shqetësime e bëjnë të përpëllitet asisoj që edhe në këtë jetë jeton një si farë Xhehenemi. Për t'i shpëtuar këtyre vuajtjeve shpirtërore, atij i nevojitet që të zhytet herë pas here në qejfe apo argëtime nga më të tepruarat. Ndonjëherë ai ia dorëzon veten alkoolit, ndonjëherë zhytet në gjithfarë kënaqësish trupore të mishit, e herë të tjera shkon deri në përdorimin e drogës me dëshirën e vetme për të mos qenë më fare aty, për të shkuar në hiçmosgjë, e shumë e shumë lloje të tjera mendimesh që mund të shkojnë ndërmend, të cilat duket sikur i falin njëfarë fashitjeje të frikës prej të shndërruarit një ditë në baltë, e cila mund t'u ketë mbërthyer shpirtat.

Me pak fjalë, krejt çakërrqejf, i dalldisur në një jetë krejtësisht boheme, ai orvatet si e si të mos mendojë e të mos ndjejë asgjë për fundin e tij. Ju mund ta quani këtë edhe si njëfarë hipnoze. Veçse, ç'e do se edhe nëse të gjitha këto arrijnë ta mashtrojnë për njëfarë kohe kalimtare, ato janë vetëm përpjekje të kota që nuk sjellin as dobinë më të vogël. Njësoj si ai struci që kërkon të fshihet prej shikimit të gjuetarit dhe e fut kokën në rërë, edhe këto lloje argëtimesh të provuara veç për t'i bërë ballë sadopak ngarkesës frikësuese se cili do të jetë përfundimi, janë po aq të padobishme për të të falur ndofarë sigurie. Nëse ka ndonjë gjë që mund ta shpëtojë atë prej këtyre shqetësimeve, e që do ta nxjerrë në bregun e shpëtimit, duke i qëndruar nën të porsin një anije e sigurt, e po ashtu si një udhërrëfyes besnik dhe burim i pashtershëm shprese, ai është besimi.

Sado mëkatar të jetë një njeri, nëse beson, atëherë ai do të ketë gjithnjë shpresë dhe njëfarë mbështetjeje në lidhje me fundin e tij. Sepse kjo e vërtetë është diçka që gjendet në vetë natyrën e besimit. Veç të tjerave, sipas besimit të Ehli Sunetit, sado mëkate të ketë kryer një njeri, nëse në zemrën e tij ka qoftë edhe një grimcë të


vockël besimi, atëherë ai nuk do të dënohet me qëndrimin e përjetshëm në Xhehenem. (Shih: et-Teftazani, Sherhu'l-Makasid, 2/229-231) Sepse, nëse te njeriu gjendet një xhevahir i atillë si besimi, mëkatet e tij nuk janë origjinare, por rastësore; nuk është besimi ai që i nxjerr ato. Ato thjesht burojnë prej mosqëndrimit në hapësirën që të ka përcaktuar ky besim. Me fjalë të tjera, mëkatet janë viruse që ngjiten pas hapësirave boshe që mund të jenë lënë të tilla për sa i përket besimit. Ndërsa kur bëhet fjalë për mohimin, atëherë mëkatet rrjedhin prej vetë natyrës së mohimit.

Kështu që, ato janë pjesë origjinare e mohimit. E nëse do të duhet të theksohet edhe njëherë, sipas besimit të përvetësuar dhe ndjekur prej të gjithë Ehli Sunetit, një njeri që ka qoftë edhe një grimcë të vogël besimi ka për të hyrë në Xhenet. Ja, pikërisht këto janë ato çfarë premton dhe përfton besimi, të gjitha nga një bukuri më vete, që nuk mund të përmbushet a zëvendësohet prej asgjëje tjetër. Kësisoj, ne mund të themi me plot gojën se besimi është një burim shumë i fortë shprese për njeriun. Një burim i fortë shprese me të cilin njeriu mund të largohet përherë prej botës së tij të ngushtë për t'u hapur drejt bukurive të pashterueshme të amshimit.

### **Pasqyrimi i përtëjmë i vëllazërisë së sinqertë**

Nga ana tjetër, besimi e kthen njeriun në një krijesë besnike dhe të sigurt për të gjitha gjallesat e tjera rreth e rrotull. Ai ia kthen atë botën e tij të ngushtë në një botë aq të gjerë, saqë mbështjell gjithë universin,

sepse besimtari e shikon gjithësinë sikur brenda një djepi të përbashkët vëllazërie. Me fjalët e Kur'anit, ai zë ta vlerësojë myslimanin vëlla për nga besimi, e atë që nuk është i atillë pikërisht pse është njeri. Patjetër që ai i sheh pak më ndryshe ata që janë besimtarë, pasi me ta ndan të njëjtat ndjenja dhe mendime, beson se me ta do të takohet në të njëjtën botë varri, e po në të njëjtin shesh gjykimi, do t'i kërkohej llogari në të njëjtin vend me ta, e po ashtu edhe në urën e Siratit po me ta do të jetë ndërsa do ta kalojë. Sakaq, një njeri që mbart një besim të këtillë nuk do të lidhet me njerëzit a me gjërat që ka përreth thjesht rreth një interesi të përkohshëm e krejt kalimtar, por do të mundohet që të formojë me ta lidhje të atilla që do të vazhdojnë të zgjatohen deri në përjetësi. Nëse Allahu xh.sh. e sheh krejt ndryshe një lidhje dhe afritet sipas një rrezeje të këtillë përjetësie, atëherë kjo do ta afrojë akoma më tepër besimtarin me Të, e kësodore Allahu xh.sh. ka për ta nxjerrë atë faqebardhë, jo vetëm në botën tjetër, por që në këtë jetë. Dhe kjo është një prej gjërave të tjera që premton besimi. Edhe fjalën e bekuar të Profetit a.s.: "Dora e Allahut është me bashkësinë" (Tirmidhiu, Fiten, 7). Pikërisht prej një këndvështrimi të këtillë mund ta vlerësoni më mirë. Domethënë, ashtu siç Allahu xh.sh. do t'i mbrojë prej çdo të keqeje, dhe do t'i ndihmojë që të dalin faqebardhë në çdo të mirë, të gjithë ata që veprojnë në bashkësi, edhe në botën tjetër do t'u falë atyre mirësi nga më të panumërtat. Me të tjera fjalë, përveç mirësive në këtë botë, veprimi i përbashkët jep fryte edhe në jetën tjetër. Siç mund të




kuptohet edhe prej fjalës së Allahut xh.sh.: “Vjen një ditë, e toka kthehet në një tjetër tokë, ndërsa qiejt në të tjerë qiej.” (Ibrahim, 14/48), gjithçka, duke filluar që nga grimcat e deri te planetët kanë për të ndryshuar të gjitha në anën tjetër. Kështu që, edhe ndjenjat dhe mendimet e njerëzve do të jenë të një tjetër natyre, duke bërë kësaj që të gjitha bukuritë e shpërfaqura, bashkë me lidhjet vëllazërore do të fitojnë një tjetër thellësi. Kushedi se ç’kënaqësi do të ndjeni atje, e në ç’lidhje afriteti e dashurie do të gjendeni me vëllezërit tuaj! Ndoshta edhe vetëm përballja me njëri-tjetrin, shikimi i fytyrës së tij, ka për të lëshuar brenda jush një gjallëri e ndjesi të atillë, që ju do ta quani të njëjtë me mirësitë e Xhenetit.

Zaten, siç thuhet edhe në hadithin: “Për robërit e mi të mirë kam përgatitur mirësi të atilla, që syri nuk i ka parë, veshi nuk i ka dëgjuar, e zemra nuk i ka ndjerë dot” (Buhari, Iman, 312). Të gjitha mirësitë e atjeshme e kapërcejnë çdolloj imagjinatë. Allahu xh.sh. ka për të falur mirësi që nuk kanë shkuar asnjëherë në mendjen e askujt. Dhe ja, këto mirësi janë pikërisht shfaqja përballë e të gjitha bukurive që ju keni shpërfaqur këtu, pasi të kenë kaluar nga njëri ndryshim në tjetrin.

Ndërsa, për sa i përket pjesës së dytë të pyetjes, duhen prekur këto çështje: Çdonjëri prej njerëzve i ndjen dhe i përjeton këto bukuri të premtuara prej besimit sipas thellësisë së besimit të tij. Disa syresh e ndjejnë këtë thjesht në mënyrë sipërfaqësore. E këta janë pikërisht ata që janë mjaftuar vetëm me të vërtetat që kanë mësuar a dëgjuar prej mësuesve në

shkollën fillore. Por në fakt, ky është vetëm fillimi i rrugëtimit. Disa të tjerë janë përpjekur që t’i vërtetojnë dhe provojnë të vërtetat e mësuar me anë të dijes dhe meditimit, duke i lidhur ato përherë pas shtyllash të forta, për t’i shpërfaqur mandej me anë të adhurimeve a një njohjeje të caktuar të së vërtetës. Domethënë, kanë ecur prej dijes sipërfaqësore drejt njohjes së dëgjuar, e prej andej drejt njohjes së dëshmuar me sytë e tyre. E pikërisht kur ke arritur në këtë pikë, aty fillon të hapet horizonti i besimit se në çdo çast je duke u parë prej Allahut xh.sh., njësoj sikur edhe ti të jesh duke e parë Atë. Njeriu bie e ngrihet me një horizont të këtillë, e po në këtë linjë mundohet që ta jetojë çdo çast të jetës së tij. Ju mund ta quani këtë edhe ecurinë e daljes nga kafshërorja, braktisjes së trupores duke shpëtuar prej kafazit të lëkurës, aq sa të ngrihesh në gradët e jetës shpirtërore. Këtu çdo gjë shihet dhe ndjehet më qartë, më thellë dhe me të gjitha ato bukuritë dhe ndriçimet e veta marramendëse. Prandaj, në një gradë të tillë nuk i jepet më kurrfarë rëndësie jetës trupore të kësaj bote. Në të qëndrohet vetëm pse ashtu është urdhëruar, se duhen kryer disa detyra të ngarkuara, të cilat duhen realizuar gjatë saj. Me të ardhur urdhri për t’u larguar së andejmi, përjetohet një tjetër gëzim, e vdekja pritët porsì një festë e hareshme, që e bën njeriun t’i afrohet së përtjemes me të gjitha bukuritë që i ka premtuar besimi. Derisa takohet me Krijuesin e Tij.



# Morali dhe universalizmi i

# Profetit Muhamed



Besimi se ekziston një fuqi e lartë e cila kontrollon universin e me këtë edhe ne, njeriut i jep një intuitë që ta shikojë këtë botë nga një prizëm krejtësisht tjetër. Shkatërrimi apo vdekja e çdo gjëje në natyrë, e bashkë me të edhe ringjallja e asaj që shkatërrohet, i jep njeriut një mësim se edhe ai është pjesë e natyrës dhe si i tillë do të pësojë ndryshimin fizik. Kuptimi dhe mendimi i thellë i kësaj e ndryshon njeriun, e bën atë më të dobishëm në atë që është e përhershme. Me kalimtarin e fiton të amshueshmen. E jeta e Muhamedit (a.s.) është shembulli më i mirë për realizimin e saj.

Ai zotëri jo vetëm që është nderuar, respektuar dhe është ndjekur rruga e tij profetike nga myslimanët në përgjithësi, por, siç dihet realisht, ai nderohet dhe vlerësohet edhe nga ithtarë të besimeve të ndryshme, të cilët i japin merita për të gjitha çështjet dhe respektohet me nderim nga dijetarë dhe shkencëtarë të mëdhenj, nga politikanë dhe filozofë të shquar, nga akademikë dhe letrarë të njohur të botës. Njëri ndër themeluesit ideologjik të Revolucionit Francez, filozofi Lafajet më 1789 para se të shpallëshin të famshmet “Të drejtat e njeriut”, i kishte studiuar të gjitha sistemet juridike dhe, duke parë lartësinë e drejtësisë islame, kishte thënë:

“O Muhamed! Atë që ti ke prurë dhe aplikuar në botë, nuk e ka bërë askush tjetër. Ti e ke sjellë drejtësinë në një vend të paarritshëm!...”

Edukata morale dhe etike si dhe influenca shpirtërore e Muhamedit (a.s.) ishte aq e thellë dhe e fuqishme, sa që njerëzit të cilët ishin gjysmë të egër, injorantë e larg civilizimit, arritën të jenë të butë, të mëshirshëm dhe të krijojnë një shoqëri të mrekullueshme e që sot historia e njerëzimit e shikon me lakmi dhe nuk njeh një gjeneratë të tillë diku tjetër.

Ai është një njeri i dërguar për ta rishikuar konfiguracionin e tokës dhe për t'i hapur njerëzimit horizonte të reja duke u pajisur, për këtë qëllim, me një shpirt dhe kapacitete të posaçme, kështu që vlerësimi i tij i kapërcen kriteret tona. Duke u nisur nga kjo, kushdo që të përpiqet për të treguar për të, nuk do të mundet ashtu siç duhet. Ajo që kalon nga zemra në gjuhë është vetëm si një pikë në gjithësinë e pafund, sepse zemrat dhe gjuhët janë të paafta për ta përshkruar Muhamedin. Ai është njeriu i dimensioneve krejt

të veçanta. Ajo çfarë neve na takon të bëjmë, është zelli për ta akorduar veten tonë në vijën dhe frekuencën e tij.

Jeta e Profetit Muhamed është e jashtëzakonshme, vlerat më të larta të etikës e moralit janë të mbledhura tek ai. Rrethi i tij i edukimit përfshinte të gjitha shtresat e njerëzimit. Të gjithë popujt, gjuhët, ngjyrat, shtresat shoqërore, sociale dhe kulturore tuboheshin rreth tij. Nuk ka asnjë shënim në të cilin thuhet se dikush e ka pasur të ndaluar të gjendej në rrethin e tij. Rrethi i tij nuk i përkiste vetëm një populli, por i përngjiste një gostie ku njeriu vlerësohej vetëm si njeri pa kurrfarë dallimi tjetër.

Kush dëshiron ta përsosë moralin e tij, le të marrë shembull prej natyrës dhe sjelljeve të shkëlqyera të Muhamedit (a.s.), i cili që prej 14 shekujsh e pasuroi njerëzimin me cilësitë më të larta të moralit. Ky njeri ofron rregulla të moralit të cilat shumë i mungojnë njeriut bashkëkohor, i cili, duke ndjekur dhe duke imituar lloje të ndryshme të etikës, është zhveshur nga normat humane. “Mos vritni gra, fëmijë dhe pleq. Mos dëmtoni pemët dhe të mbjellat.” ishin fjalët e tij kur bënte luftë mbrojtjeje ndaj armiqve. Në një thënie të tij thotë: “Butësia dhe mirësjellja e cila nuk duket shumë e rëndësishme në këtë botë, nesër në Ditën e Gjykimit do të ketë rëndësi shumë të madhe”.

Siç shihet dërgimi i Muhamedit (a.s.) është mëshirë nga Zoti i madhëruar që njerëzit t'i zgjidhin problemet e tyre në mënyrë të drejtë dhe humane, sepse Ai që na krijoi më së miri i di nevojat e krijesave, prandaj përmes Kuranit dhe traditës profetike ofron udhëzime afatgjatë dhe të përsosura.

Pejgamberi (a.s.) me moralin e tij të lartë që ia kishte dhuruar Allahu, i vlerësonte të gjithë njerëzit pa marrë parasysh se cilës feje i përkisnin. Ja një shembull pse njerëzit duhen të krenohen me këtë Profet. Një ditë tek po qëndronte me një shok të tij pranë rrugës, aty kalon një xhenaze hebreu dhe ai menjëherë ngrihet në këmbë në shenjë respekti. Shoku i tij i thotë: “O i dërguari i Allahut! Ai ishte një hebre”, ndërsa Resulullahu (a.s.) pa u zemëruar fare iu përgjigj: “Pse, a nuk është njeri me shpirt edhe ai?!” Pra, mbi të gjitha, është njeri dhe kësaj thënieje nuk mund t'i shtojmë asgjë tjetër. Nëse ne jemi umeti dhe ndjekësit e zotërisë së kësaj thënieje, nuk kemi se si të mendojmë ndryshe nga ai. Nga kjo thënie



dhe sjellje e mirë e Profetit (a.s.), kuptojmë se njeriun ngase është njeri duhet ta duam dhe ta respektojmë, sepse kjo tregon respektin ndaj Krijuesit. Përndryshe nuk do të ishte dashuri dhe respekt i singërtë.

Parim kryesor në kulturën tonë është: të duash krijesat për hir të Krijuesit. Sepse Allahu e krijoi gjithësinë me dashuri. Dashuria është shkaku dhe thelbi i ekzistencës si dhe është lidhja më e fortë për bashkimin dhe marrëdhënien e krijesave njëra me tjetrën. Çdo gjë që ekziston në këtë gjithësi është një art i Allahut Fuqiplotë. Nga ky këndvështrim, nëse ne nuk i duam njerëzit që janë një art i Allahut, atëherë kemi zemëruar Allahun, ata që i do Ai dhe ata që e duan Atë. Shembull për këtë është se nëse ne futemi në pallatin mbretëror dhe nuk i përfillim fare zbulimet dhe dekoracionet e tij, atëherë do të ofendohet edhe arti edhe arkitekti i tij. E njëjta gjë është edhe me bukuritë mahnitëse të këtij universi që është një art i Allahut të madhëruar. Nga kjo pikëpamje, jo vetëm njerëzit, kafshët dhe krijesat me shpirt, por, edhe ato pa shpirt duhet t'i duam. Përbuzja dhe nënvlerësimi i tyre do të thotë nënvlerësim i Krijuesit të tyre.

Mënyra e sjelljes me njerëzit mbështetet në parimin: t'i duam krijesat për hir të Krijuesit. Nëpërmjet kësaj, ne si myslimanë që jemi, nëse atyre që ballafaqohemi u flasim për shpatën, mburojën, vrasjen dhe prerjen, krijojmë ndërmjet atyre dhe nesh një greminë. Dhe nëse ka ndodhur një gjë e tillë, kjo do të thotë se jemi larguar nga caqet (kufijtë) e fesë.

Një besimtar, duke filluar nga të afërmit dhe më gjerë, duhet të përhapë dritën e dashurisë, miqësisë dhe të dialogut. Çdo mysliman përballë krijesave të tjera, duhet ta mbushë zemrën e tij me ndjenjën e mëshirës për hir të Krijuesit. Nëse do e përmbledhim shkurtimisht, qëllimi kryesor i besimtarit nuk është të heshtë ata që nuk besojnë si ai, por t'u fitojë zemrat atyre.

Allahu e dërgoi Musain tek Faraoni dhe i tha: "Thuaji fjalë të buta, ndoshta ai mendohet a frikësohet". Nga ky ajet kuptohet që megjithëse Faraoni e kishte luftuar Musain dhe popullin e tij, ai duhet t'i fliste me një gjuhë të ëmbël dhe me fjalë të buta dhe prekëse. Sepse qëllimi nuk është të hakmerresh, por t'i ftosh njerëzit drejt së vërtetës dhe shpëtimit. Në këtë ajet, pikë kryesore është: "Kaulun Lejinun" pra, fjala e butë. Atëherë personit që është përballë teje cilido qoftë ai, nëse dëshiron t'i shpjegosh diçka, është kusht që t'i flasësh butë dhe të tregohesh tolerant ndaj tij. Përsëri Allahu në Kuran thotë: "Të keqen ktheje me të mirë, sepse atëherë ai me të cilin kishit njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt".

Misioni i Profetit (a.s.) ishte të kumtonte fenë Islame dhe ai gjatë gjithë jetës së tij pa marrë parasysh asgjë ua kumtoi të gjithëve fenë e vërtetë. Siç shkruhet në librat që tregojnë jetën e të dërguarit të Allahut, se ai, njeriu i paqes, edhe Ebu Xhehli, armikut më të madh të Islamit, ia kishte shpjeguar dhe kumtuar Islamit më shumë se njëqind herë pa u mërziur fare. "Një radhë Pejgamberi (a.s.) doli përpara nesh dhe na e shpjegoi edhe një herë fenë Islame duke na thënë: "Thoni

nuk ka Zot tjetër përveç Allahut që të shpëtoni". Aty gjendej edhe Ebu Xhehli ku kësaj thirrjeje iu përgjigj duke e tallur dhe përqeshur: "O Muhamed! Nëse të gjitha këto i bën që kur të dalim përpara Allahut, të dëshmojmë se ti e kumtove fenë, atëherë edhe një herë mua mos me fto më, sepse unë do të dëshmoj se Resulullahu e kreu me sukses misionin e tij duke e shpjeguar dhe sqaruar mirë fenë Islame".

Ebu Xhehli përherë kështu e ofendonte dhe tallej me të, mirëpo Profeti (a.s.) sa herë që e takonte i tregonte për Islamit dhe asnjëherë nuk ia kthente me të keq. Tani që Pejgamberi i mëshirës duke qenë kaq i ndjeshëm në çështjen e respektit ndaj njerëzve, si ka mundësi që në ditët e sotme ka prej tyre që – duke u bazuar në fe, vazhdojnë me forcë dhe me dhunë? Ndoshta këta nuk e kanë kuptuar të dërguarin e kësaj feje, Hz. Muhamedin (a.s.)!

Poshtë këtij titulli shkurtimisht mund të themi që në Islam, bazë kryesore është falja dhe toleranca, sepse Resulullahu (a.s.) thotë: "Bëhu tolerant që të tolerohesh". Përfundimisht mund të themi se as në Islam, as tek Pejgamberi (a.s.) nuk ekziston urrejtja dhe mëria. Dashuria, toleranca dhe durimi janë armë që mundin çdo armik dhe çelësa që hapin çdo derë. Nuk ka dyshim se tek ata që gjenden këto cilësi, nëse sot jo, nesër patjetër që do t'i hapin të gjitha dyert e kësaj bote.

Ikrimë b. Ebi Xhehli, që ishte një ndër armiq të Islamit, në kohën e çlirimit të Mekës pati ikur nga frika. Pastaj me ndërmjetësim të zonjës së asaj krahine Ummu Hakim, ishte sjellë përpara Resulullahut (a.s.). Përpara se të vinte tek Profeti (a.s.) i kishin thënë se nëse kërkon falje ai do të të falë ty.

I dërguari i Allahut përpara se të vinte Ikrimë, i paralajmëron shokët e tij duke u thënë: "Po vjen Ikrimë, mos e fyeni atë duke përdorur fjalë të pahijshme për babanë e tij". Sa futet Ikrimë, i dërguari i Allahut ngrihet dhe e përqafton duke i shprehur mirëseardhjen. Ikrimë nuk e imagjinonte kurrë një gjë të tillë dhe më vonë do të shprehej: "Nuk e kam harruar kurrë atë sjellje aq të mirë të Pejgamberit (a.s.)".

Një shembull tjetër është Abdullah Ibn Ubej b. Selul. Ai jetonte në Medinë me Ehli Kitabin (hebrenjtë dhe të krishterët) dhe mendohej sa më shumë që t'i ngatërronte myslimanët njëri me tjetrin, por nga dyfytërsia thoshte që jam mysliman. Profeti (a.s.) edhe me atë ishte i durueshëm edhe pse e dinte shumë mirë se ai ishte hipokrit. Abdullahu gjatë gjithë jetës së tij kishte armiqësi dhe e urrente të dërguarin e Zotit. Kur kishte vdekur, djali i tij i kishte kërkuar Resulullahut që të jepte këmishën e vet si qefin për babain, dhe ai ia kishte dhënë. Deri në atë kohë nuk kishte ardhur shpallja për mosfaljen e namazit të xhenazës së tij dhe, për këtë shkak Profeti ia kishte falur xhenazën. Nga ky këndvështrim nuk mund të gjejmë mesazh të ngjashëm me këtë të Pejgamberit që ia paraqiti njerëzimit. Pikërisht për këtë shkak është quajtur "usvetu hasene", me moral të lartë dhe shembull për mbarë njerëzimin" dhe s'ka mundësi që një mysliman të mendojë ndryshe nga ai.

# ARDHJA E KRENARISË SË NJERËZIMIT (S.A.S.)

لَقَدْ مَنَّ اللَّهُ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ إِذْ بَعَثَ فِيهِمْ رَسُولًا مِنْ أَنْفُسِهِمْ  
يَتْلُو عَلَيْهِمْ آيَاتِهِ وَيُزَكِّيهِمْ وَيُعَلِّمُهُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ

Një botë sterrë e zezë e mbarsur me dritë... Në horizont, jehona mbushur plot sihariqe për kohën e shkurtër të mbetur gjer në shfaqjen e të shumëpriturit... Aq i madh është ndikimi i tij nëpër ndërgjegje, sa shumë mekas tregojnë vazhdimisht për Profetin e Fundit që do të vijë. Dhe një porosi: "Sapo të shfaqet, vraponi për tek ai dhe bëhuni një me shpirtin e tij!"

Ai e kishte të përcaktuar rrugën e tij: do të kalonte nëpër brezin e artë që përçohet nga Hz. Ibrahim te Ismaili dhe, pastaj, nga Abdullmuttalibi te Abdullahu dhe zemrat prisnin dritën që do të vinte përmes këtij drejtimi.

Ngjarjet që kishin ndodhur e ndodhnin, për ardhjen e tij lajmëronin, kurse dendësimi i errësirës fliste për afrimin e agimit që do ta griste errësirën.

Njerëzimi i asaj dite ishte i privuar nga ideali dhe qëllimi që i japin kuptim jetës. E gjithë vepra njerëzore ishte **كَسْرَابٍ بِقِيَعَةٍ**... "si ndjekja e një iluzioni optik në shkretëtirë. I eturi e pandeh për ujë atë, por, kur arrin në vend, nuk gjen gjë..." (Nur: 39)

Edhe ndjenjat, mendimet dhe sjelljet e njerëzve nuk ndryshonin shumë nga kjo. **كَظَلَمَاتٍ فِي بَحْرِ لَجِّي يَغْشَاهُ مَوْجٌ مِنْ فَوْقِهِ ...** Ato ishin ... **مَوْجٌ مِنْ فَوْقِهِ سَحَابٌ، ظَلَمَاتٌ بَعْضُهَا فَوْقَ بَعْضٍ، إِذَا أَخْرَجَ يَدَهُ لَمْ يَكَدْ يَرَاهُ**... "si errësira e dendur në një det të gjerë ku njerëzimin e kishin mbuluar dallgë mbi dallgë e sipër tyre re aq sa, po të nxirrte dorën jashtë, edhe atë nuk do ta shihte dot!" (Nur: 40)

Emri i asaj periudhe është Injorancë. Por jo një injorancë si antonim i dijes; ajo ishte një injorancë - sinonim i mohimit dhe herezisë, që janë antonime të besimit.

Ardhja e tij është për çdo njeri favorit më i

madh dhe mirësia më e gjerë e Zotit. Dhe këtë, na e thotë vetë Zoti ynë: لَقَدْ مَنَّ اللَّهُ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ إِذْ بَعَثَ فِيهِمْ رَسُولًا مِنْ أَنْفُسِهِمْ يَتْلُو عَلَيْهِمْ آيَاتِهِ وَهُدًى وَرَحْمَةً... "Allahu u ka bërë një favor të madh besimtarëve duke u dërguar nga mesi i tyre një pejgamber që t'u lexojë argumentet e Tij, t'i pastrojë (nga të këqijat, nga mëkatet) dhe t'ua mësojë Librin dhe urtësitë" (Al Imran: 164).

I paralajmëruari

Lutja e Ibrahimit (as), sihariqi i Isait (as)

Një ditë, njëri prej pasuesve i thotë Profetit: "O i Dërguari i Allahut, a nuk po na flet pak për veten?" Në një pjesë të përgjigjes së vet, Profeti shprehet kështu: "Unë jam lutja e Ibrahimit dhe sihariqi i Isait!"

1) Ibrahim (a.s), duke ndjekur urdhërin e të Madhit Zot do të vinte në luginën e Bekës së bashku me bashkëshorten Haxhirenë dhe të birin aq të dashur Ismailin, i cili atëherë ishte tepër i vogël. E përsëri me urdhër të Allahut do të largohej prej aty duke i braktisur nënë e bir në mes të shkretëtirës pa pikën e ujit. Por ata ishin njerëz të dorëzuar e të bindur ndaj Allahut dhe e dinin, që Ai nuk i kishte sjellë më kot në një vend të atillë. Haxhireja nis të vrapojë nga një kodër në tjetrën për të kërkuar ujë dhe herë pas here kthente sytë tek i biri. Pasi e bëri disa herë ik e hajde nga një majë në tjetrën, një lëvizje e fëmijës i tërheq vëmendjen dhe vrapon tek ai. Kur ç'të shihte, në mes të shkretëtirës nis të burojë ujë me bollëk. Kjo ishte një shenjë e qartë për shenjtërinë e atij vendi.

E pikërisht aty në mes të maleve Faran nis një jetë e re. Qyteza që mori jetë me ujin e zemzemit u kthye tanimë në një qytezë të begatë, fole e njerëzish të begatë.

Ku ta dinte Haxhireja që aty po përgatitej ardhja e Zotërisë së njerëzimit, s'kishte nga ta dinte që vrap i saj nga një kodër në tjetrën do të ishte rrugë e haxhinjve nga Safa në Merve, nuk kishte nga ta dinte që me atë zemzem do të freskohej e do të merrte abdest Krenaria e njerëzimit. Dhe kështu lutja e Ibrahimit (a.s) plotësohet: رَبَّنَا وَابْعَثْ فِيهِمْ رَسُولًا مِنْهُمْ يَتْلُو عَلَيْهِمْ آيَاتِكَ وَيُعَلِّمُهُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَيُزَكِّيهِمْ إِنَّكَ أَنْتَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ "Zoti ynë! Dërgoju një përfaqësues nga mesi i tyre që t'u lexojë ajetet e Tua, t'u mësojë Librin dhe urtësinë e t'i pastrojë (prej idhujtarisë). Ti je i Dituri, Sovrani." (Bakara: 129)

2) Kurse Isai (a.s) i tregonte kështu popullit të tij: وَإِذْ قَالَ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ يَا بَنِي إِسْرَائِيلَ إِنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُمْ مُصَدِّقًا لِمَا بَيْنَ يَدَيَّ مِنَ التَّوْرَةِ وَمُبَشِّرًا بِرَسُولٍ يَأْتِي مِنْ بَعْدِي اسْمُهُ أَحْمَدُ فَلَمَّا جَاءَهُمْ بِالْبَيِّنَاتِ قَالُوا هَذَا سِحْرٌ مُبِينٌ "Kujto se Isai, biri i Merjemes tha: "O të bijtë e Izraelit! Unë jam i dërguari i Allahut tek ju, jam vërtetues i Teuratit(i) të dërguar para meje dhe përgëzues për një të dërguar që do të vijë pas meje, emri i të cilit është Ahmed." Dhe kur ai u paraqiti argumente të qarta, ata thanë: "Kjo është një magji e hapët!" (Saff: 6)

Të gjithë flisnin për ardhjen e tij

Librat e shënjtë paralajmëronin ardhjen e një njeriu të veçantë

Ungjilli tregonte: "Mesihu tha: Unë po shkoj te Zoti im dhe juaji gjersa të dërgojë tek ju Faraklitin i cili do të sjellë Interpretimin".

Kështu Zejd b. Amri do të jepte jetë duke kërkuar për Të, Kus b. Saide do të mërgonte drejt botës tjetër duke kërkuar po Atë, në çdo panair që shkonte përmendte emrin e të Dërguarit të Fundit (a.s), Mekasit do të dëgjonin po emrin e tij në klithmat e Uaraka b. Neufelit. Dhe kjo pritje nuk zgjati shumë. Më 20 prill 571, ose 12 rabiul euvel ditën e hënë Ai shndriti më fortë se dielli. Muhammed thotë e jëma Emine, Muhammed e quajta, që të jetë i lartësuar si në qiej edhe në tokë. Dhe i lartësuar u bë emri i tij si në qiej edhe në tokë إِنَّ اللَّهَ وَمَلَائِكَتَهُ يُصَلُّونَ عَلَى النَّبِيِّ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا صَلُّوا عَلَيْهِ وَسَلِّمُوا تَسْلِيمًا thotë Allahu. Kështu lartësohen salavatet vetëm e vetëm për Profetin Ahmed Muhammed Mustafa (alejhi ekmeluttehaja uetteslimat)

Bajramet janë festa të pasura e të begatshme, shprehje të afrimit të Zoti, shprehje të ndarjes me të tjerët të gëzimit të jetës. Por është edhe një festë tjetër që konsiderohet festa e të gjithë njerëzimit, madje e të gjithë qenies, së bashku me njerëz e xhindë, dita kur i Dërguari i Allahut na nderoi duke denjuar të vijë mes nesh, është Ditëlindja Muhamediane. Me fjalë të tjera, është dita kur Zoti, Dritën që e krijoi në cilësinë e një dielli, e zbriti si një kandil në qiellin e njerëzimit. Po, në saje të asaj Drite, të gjitha errësitat e injorancës u grisën dhe gjithësia u përfshi nga ndriçimi. Dhe kjo është ndihma më e madhe dhe favorit më i madh i Zotit, Dritë për xhindët e për njerëzit! Një Dritë e Pashuar për gjithësinë!



## 01 ÇELET VITI I RI AKADEMIK 2025-2026 NË TË GJITHË VENDIN



Sot, në mbarë vendin, ashtu si gjithë institucionet e tjera arsimore, medresetë çelën zyrtarisht vitin e ri shkollor 2025-2026, duke hapur dyert për qindra nxënës të rinj që nisin rrugëtimin e dijes dhe edukimit.

Në Medresenë e Tiranës, në ceremoninë e organizuar me këtë rast, të pranishëm ishin Nënkrjetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Lauren Luli, si dhe Drejtori i Arsimit në KMSH, z. Elton Karaj. Ata përshëndetën nxënësit, mësuesit dhe prindërit, duke theksuar se medreseja mbetet një institucion unik që kombinon formimin shkencor me edukimin moral e fetar.

Po ashtu, në Medresenë e Elbasanit, Nënkrjetari i KMSH-së, z. Tauland Bica, mori pjesë në hapjen e vitit të ri shkollor, duke uruar mbarësi dhe suksese për të gjithë nxënësit. Ai theksoi se medresetë kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin një kontribut të çmuar në përgatitjen e brezave të rinj të ditur, të përgjegjshëm dhe me vlera të forta morale dhe etike.

Ceremoni hapëse u zhvilluan gjithashtu edhe në Medresenë e Shkodrës "H. Sheh Shamia", dhe Medresenë e Durrësit "Mustafa Varoshi", ku drejtuesit e institucioneve, së bashku me stafet pedagogjike, i uruan nxënësit për një vit të mbarë dhe të suksesshëm.

Drejtorët e medreseve shprehën mirënjohje për prindërit që u besojnë fëmijët e tyre gjatë këtij rrugëtimi, duke theksuar përkushtimin e stafit mësues për të ofruar arsim cilësor dhe edukim të shëndetshëm shpirtëror.









## 02 PROGRAM FETAR KUSHTUAR PROFETIT MUHAMED (a.s) (MEVLUDI) NË XHAMINË ET'HEM BEU



Në kuadër të muajit të lindjes së të Dërguarit të Allahut a.s, ditën e sotme, para namazit të xhumasë, në Xhaminë Et'hem Beu u zhvillua një program fetar kushtuar jetës dhe veprës së Profetit Muhamed a.s.

Në këtë program ishin të pranishëm Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, nënkryetarët e institucionit, z. Luren Luli dhe z. Taulant Bica, imami i xhamisë, z. Elton Karaj, si dhe besimtarë të shumtë të Tiranës.

Gjatë fjalës së tij, kryetari Spahiu theksoi shembullin e Profetit Muhamed a.s si modelin më të mirë për njerëzimin, për paqen, mirësitë dhe për mënyrën se si duhet t'i drejtohem Allahut a.s në adhurimet tona.

Ndërsa imami i xhamisë, z. Elton Karaj, ndau me të pranishmit rrëfimin e el-Utbijit për beduinin pranë varrit të Profetit a.s, ku ky i fundit gjen faljen e Allahut Fuqiplotë. Ai theksoi mesazhin e madh që përcjell kjo ngjarje - gjynahqarët që i kthehen Allahut (xh.sh) me pendim të sinqertë dhe që kërkojnë ndërmjetësimin e të Dërguarit a.s, gjithmonë gjejnë portën e mëshirës të hapur.

Gjatë këtij programi u lexua gjithashtu Kuran nga hafizi Enes Hyka, pjesë nga Mevludi Sherif si dhe u mbyll me duanë e imamit të xhamisë.



### 03 SESIONI I TRETË I TRAJNIMIT SHKENCOR-FETAR PËR IMAMËT DHE HATIBËT NË SHQIPËRI



Komuniteti Mysliman i Shqipërisë çeli sot në ambientet e Kolegjit Universitar “Bedër”, sesionin e tretë trajnues shkencor-fetar për imamët dhe hatibët e xhamive të Republikës së Shqipërisë.

Ky trajnim u realizua në bashkëpunim me Atasheun Fetar të Mbretërisë së Arabisë Saudite në Bosnjë dhe Hercegovinë. Në ceremoninë e hapjes, morën pjesë; Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Sh.T.Z. Faisal bin Ghazi Hefdh, Ambasadori i Mbretërisë së Arabisë Saudite në Shqipëri, Shkëlqesia e Tij Shejh Abdul Latif bin Nasser Al-Hussein, Atasheu Fetar i Mbretërisë së Arabisë Saudite në Bosnjë dhe Hercegovinë, si dhe një numër i konsiderueshëm myftinjsh, imamësh e hatibësh të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Në fjalën e tij të rastit, kryetari Spahiu, theksoi se ky trajnim pasqyron përkushtimin e institucionit për të mbështetur formimin e vazhdueshëm të imamëve dhe hatibëve. Ai nënvizoi rëndësinë e zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve të tyre si një mjet për forcimin e rolit të xhamive në shërbim të komunitetit.

Ndërsa Ambasadori Hifdh, nënvizoi mbështetjen e vazhdueshme të Arabisë Saudite për nisma të tilla që synojnë forcimin e bashkëpunimit fetar e kulturor ndërmjet dy vendeve. Ai përshëndeti përkushtimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe rolin aktiv të imamëve e hatibëve në përcimin e mesazheve të pastra islame, duke shprehur mirënjohjen për frymën e bashkëpunimit të deritanishëm.

Ky trajnim do të zgjasë për disa ditë, me qëllim ngritjen e kapaciteteve shkencore dhe thirrëse të imamëve e hatibëve.





## 04 NJË GRUP PREJ 27 INTELEKTUALËSH GJERMANË VIZITOJNË KMSH-NË



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti sot në një takim një grup prej 27 intelektualësh gjermanë, mes të cilëve kishte studiues, teologë dhe aktivistë, të interesuar për të njohur nga afër Islamin në Shqipëri dhe modelin e bashkëjetesës fetare në vendin tonë.

Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, i njohu vizitorët me veprimtarinë e Komunitetit Mysliman në fusha të ndryshme, duke përfshirë arsimin, edukimin fetar dhe aktivitetet sociale. Ai foli mbi vlerat paqësore të Islamit dhe mënyrën se si ato përcillen tek qytetarët shqiptarë, duke theksuar rëndësinë e dialogut dhe harmonisë ndërfaqetare.

Gjatë takimit, vizitorët gjermanë shtruan pyetje mbi funksionimin e institucioneve fetare në Shqipëri, mbi raportin e fesë me shoqërinë dhe mbi perspektivat e zhvillimit të mëtejshëm të dialogut ndërfaqetar, si dhe parashtuan pyetje konkrete mbi tema të ndryshme, duke kërkuar të kuptonin këndvështrimin islam mbi këto çështje.

Ata vlerësuan modelin shqiptar të bashkëjetesës si një përvojë frymëzuese për Evropën dhe më gjerë.

Takimi u zhvillua në një atmosferë miqësore dhe të hapur, ku palët shkëmbyen mendime dhe përvoja mbi çështje me interes të përbashkët. Vizitorët shprehën falënderimin e tyre për mikpritjen dhe informacionin e vlefshëm të marrë gjatë vizitës, duke shprehur dëshirën për të thelluar bashkëpunimin dhe komunikimin në të ardhmen.



## 05 KMSH NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME QENDRËN E FORMIMIT PROFESIONAL



Komuniteti Mysliman i Shqipërisë nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën e Formimit Profesional Publik, me qëllim ofrimin e mundësive të reja për zhvillim profesional dhe ekonomik për personat e interesuar.

Marrëveshja u nënshkrua sot ndërmjet Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, dhe znj. Valbona Hoxha, Drejtore e Qendrës së Formimit Profesional Publik.

Gjatë këtij takimi, i cili u zhvillua në selinë e institucionit, të dy drejtuesit theksuan rëndësinë e këtij partneriteti, i cili do të kontribuojë në rritjen e mundësive të punësimit, forcimin e kapaciteteve profesionale dhe mbështetjen e integritit social-ekonomik të qytetarëve.

Marrëveshja fokusohet në dy drejtime kryesore:

1. Referimin e personave të interesuar për t'u përfshirë në kurset dhe programet e trajnimit profesional që ofron Qendra.
2. Ofrimin e mundësisë për personat e papunë që të aplikojnë për grante për hapjen e bizneseve apo sipërmarrjeve të ndryshme.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë shpreh gatishmërinë për të mbështetur projekte të tilla, të cilat kontribuojnë në mirëqenien e qytetarëve dhe zhvillimin e shoqërisë.





# Kur natyra **ankohet**





Natyra, kjo krijesë e bukur e Krijuesit, që duket sikur flet me gjuhën e saj. Kjo krijesë, ndaj së cilës më së shumti i është bërë padrejtësi, sikur i thotë njeriut: Më shiko mua, më vështro përreth! Unë jam krijuar për të qenë në shërbimin tënd, ndaj pse u dashka të më quaje "Krijues"?! Unë erdha për t'i shërbyer njeriut! Unë kam Krijuesin tim!

Allahu i Madhëruar natyrën ia nënshtroi njeriut dhe atë e bëri të përmbajtur. Allahu ia nënshtroi njeriut ajrin, detet, diellin, hënën, yjet, pluhurin, erërat. Njeriu shërbehet me metale, bimë dhe kafshë, sipas ligjeve sipas të cilave noton gjithësia, që të jetë e dobishme.

**"A nuk e dini ju se Allahu nënshtroi për të mirën tuaj çka në qiej e çka në toke dhe plotësoi ndaj jush të mirat e Tij të dukshme e të fshehta, e megjithatë prej njerëzve ka që polemizojnë çështjen e Allahut duke mos pasur as dituri, duke mos qenë i udhëzuar dhe duke mos pasur libër të ndritshëm."** (Lukman, 20)

Një pyetje që na vjen në mendje është: "Si është e mundur që ata filozofë të famshëm dhe të ashtuquajtur brilantë e pranuan një besëtytni të turpshme të tillë, ia dorëzuan asaj mendjet e tyre dhe vazhdojnë ta ndjekin atë rrugë?"

Idhulli i ri i ka përfshirë të gjithë idhujt e mëparshëm, kjo është natyra, e cila përbëhet nga yjet më të gjitha veçoritë e tyre, hëna më të gjitha veçoritë e saj, njeriu më të gjitha veçoritë e tij, kafshët më të gjitha veçoritë e tyre, uji më të gjitha veçoritë e veta. Kështu janë përmbledhur të gjithë idhujt e mëparshëm në një idhull, e ky është idhulli me i madh, idhujtarët e konsiderojnë se ky është krijues!

Allahu xh.sh. në Kur'anin Famëlartë thotë: **"Të dërguarit e tyre u thanë: "(çfarë)?! A ka dyshim për Allahun, Krijuesin e qiejve e të tokës!?"** (Ibrahim, 10)

Gjëja imagjinare dhe jolëndore që natyralistët e quajnë natyrë, nuk ka një realitet; në qoftë se ajo duhet të ketë një ekzistencë reale të jashtme, atëherë kjo "ekzistencë" është: një vepër arti; ajo nuk mund të jetë artisti. Ajo është një qëndisje dhe nuk mund të jetë qëndistari. Ajo është një koleksion dekretesh; ajo

nuk mund të jetë lëshuesi i dekreteve. Ajo është një përmbledhje e ligjeve të krijimit; ajo nuk është Ligjvënësi. Ajo është vetëm një perde e krijuar për dinjitetin e Zotit xh.sh.; ajo nuk mund të jetë Krijuesi. Ajo është pasive dhe e krijuar; ajo nuk mund të jetë autori i krijimit. Ajo është një ligj, jo një fuqi dhe nuk mund të posedojë fuqi. Ajo është marrëse-përfituese, ajo nuk mund të jetë burimi.

Madhështia e artistit vlerësohet me vlerën e veprave të tij. Zogj këngëtarë, lule ngjyra-ngjyra, hollësi të një arti mrekullor të vëzhguara edhe në qenien më të vogël e sa e sa të tjera. Në të gjitha këto, Allahu, me gjuhën e natyrës, i bën të shqiptohen e këndohen emrat dhe atributet e Tij dhe, duke i ekspozuar shfaqjet e këtyre emrave dhe attributeve nën emërtimin "shkaqe", ua paraqet qenieve të vetëdijshme për t'i vëzhguar e soditur. Kurse vetë sodit habinë dhe mahnitjen e tyre!

Njeriu është më i përpunuar se sa natyra. Nëse njeriu mendon mbi veten e tij, do të zbulojë se është:

\* ai është i arsyeshëm, kurse natyra nuk ka arsye.

\* ai ka dituri, kurse natyra nuk ka dituri.

\* ai ka vullnet, kurse natyra nuk ka vullnet.

\* ai ka shqisa, kurse natyra nuk ka shqisa.

\* ai ka shikim, kurse natyra nuk sheh.

\* ai posedon shqisa dhe ndjenja, kurse natyra nuk ka mençuri.

\* ai punon me mençuri, kurse natyra nuk ka mençuri.

\* ai ka sjellje të mirë-moral, kurse natyra nuk ka moral.

Atëherë, pse do të duhej që njeriu, krijesa më e pajisura me virtytet dhe më vlerat më të larta humane të bijë në këtë humnerë të pafund?

Përgjigjen ua lejmë atyre që filluan jetën e tyre dhe e mbaruan, por asnjëherë nuk arritën ta njohin Krijuesin e tyre! Ata nuk bënë gjë tjetër pos mohuan Atë që i krijoi, që i ju dha jetë, mendje dhe logjikë. **"..pra merrni përvojë, o ju të zotët e mendjes!"** (Hashr, 2)

# Qëndrimi Islam ndaj ndërrhyrjeve estetike dhe kirurgjikale

Në Islam, qëndrimi ndaj ndërhyrjeve estetike dhe kirurgjike është një çështje e ndërlikuar, subjekt i interpretimeve të ndryshme nga dijetarët.

Në radhë të parë duhet të kuptojmë qasjen e fesë ndaj krijimit të njeriut. Allahu i Madhëruar, që e ka krijuar njeriun në mënyrën më të bukur, ka lejuar që ai të zbukurohet dhe të ruajë bukurinë e tij në masa të arsyeshme dhe të moderuara. Në Kuran thuhet se gjërat e mira dhe të bukura janë të lejuara, ndërsa gjërat e këqija dhe të shëmtuara janë të ndaluara (Maide 5/4-5). Një suren A'raf thuhet: "Thuaj: 'Kush i ka penguar stolitë dhe ushqimet e këndshme, të cilat Ai i ka krijuar për robërit e Vet?' Thuaj: 'Ato janë për besimtarë (dhe të tjerët) në këtë botë, ndërsa në botën tjetër do të jenë vetëm për besimtarët. Kështu ua shpjegojmë shpalljet njerëzve që dinë.'" (A'raf 7/32). Profeti Muhamed (a.s), kur iu bë një pyetje rreth veshjes së bukur, ka thënë: "Allahu është i bukur dhe e do bukurinë" (Muslim, Iman, 41). Ai (a.s) gjithashtu ka qenë gjithmonë i pastër dhe i rregullt në jetën e tij dhe ka inkurajuar veshjen e thjeshtë dhe të bukur, si dhe përdorimin e aromave të këndshme.

Nga ana tjetër, në Islam, ndryshimi i karakteristikave dhe pamjes natyrore të njeriut, si dhe çdo ndërhyrje estetike ose mjekësore, që synon ta ndryshojë atë, nuk është mirëpritur. Këto ndërhyrje janë konsideruar si përpjekje për të prishur natyrshmërinë. Ndërhyrjet që synojnë të ndryshojnë krijimin e natyrshëm janë të ndaluara (Nisa 4/119). Profeti Muhamed (s.a.s) e ka konsideruar praktikën e bërjes së tatuazheve në trup dhe atë të mpresjes së dhëmbëve për qëllime estetike si ndërhyrje që ndryshojnë krijimin origjinal dhe prishin natyrshmërinë e njeriut. Ai i ka dënuar këto veprime (Buhari, Libas, 83-87; Muslim, Libas, 33).

Parimet thelbësore që duhen pasur parasysh në lidhje me ndërhyrjet estetike mund të përmbledhen si më poshtë:

**Qëllimi dhe nevoja:** Nëse ndërhyrjet plastike janë të nevojshme për arsye mjekësore, si për të korrigjuar defekte të lindura, lëndime ose probleme shëndetësore që ndikojnë në mirëqenien e individit, ato zakonisht konsiderohen të lejueshme. Për shembull, operacionet për të riparuar dëmtimet pas një aksidenti ose për të korrigjuar deformime të shkaktuara nga ndonjë sëmundje janë

përgjithësisht të pranueshme.

**Ndryshimi i krijimit të Zotit:** Islami ka një ndalim të qartë për ndryshimin e krijimit të Zotit, që është i shprehur në disa ajete të Kuranit dhe në hadithe. Ky ndalim ka të bëjë më shumë me ndërhyrjet që nuk janë të nevojshme dhe që përpiqen të ndryshojnë pamjen natyrore të individit për qëllime estetike. Për shembull, ndryshimet që bëhen për të ndjekur standarde të bukurisë, të cilat nuk janë të nevojshme për arsye shëndetësore, mund të jenë të diskutueshme dhe shpesh konsiderohen të papranueshme.

**Të mos dëmohet shëndeti dhe pamja:** Çdo ndërhyrje që mund të rrezikojë shëndetin ose të shkaktojë dëmtime të panevojshme është e papranueshme në Islam. Ndërhyrjet plastike që përfshijnë rreziqe të larta dhe që nuk ofrojnë përfitime shëndetësore të qarta janë të papranuara.

**Njerëzimi dhe nderi:** Islami thekson rëndësinë e ruajtjes së nderit dhe personalitetit të individit. Ndërhyrjet plastike të motivuara nga komplekset e jashtme, shkelin dukshëm këtë parim.

**Këshilla dhe mendime profesionale:** Para se të merret një vendim për një ndërhyrje plastike, është e rëndësishme të konsultoheni me mjekë myslimanë të besueshëm dhe me njohës të mirë të fesë për të kuptuar nëse ndërhyrja është në përputhje me parimet islame dhe të siguroheni që është e nevojshme për arsye shëndetësore.

Mund të themi që ndërhyrjet estetike janë të lejueshme në përputhje me kushtet e mëposhtme:

Nuk duhet të bëhet me qëllimin për të ndryshuar krijimin origjinal dhe për të prishur natyrshmërinë e trupit,

Kur ka një mundësi të lartë që ndërhyrja të sjellë dobi ose të largojë një defekt ekzistent,

Ndërhyrja duhet të bëhet në kornizën e trajtimeve mjekësore,

Ndërhyrja nuk duhet të bëhet me qëllim mashtrimi ose për të imituar fizikisht gjininë tjetër.

Në përmbledhje, ndërhyrjet plastike në Islam janë të lejueshme nëse ato janë të nevojshme për arsye shëndetësore dhe nuk përpiqen të ndryshojnë krijimin natyror të Zotit për qëllime estetike. Çdo vendim për të kryer një ndërhyrje plastike duhet të bëhet duke u mbështetur në këshilla të kujdesshme dhe në respektimin e parimeve islame.



# STILET E PRINDËRIMIT

## Si ndikojnë tek fëmijët

Prindërimi është një përvojë sa sfiduese por edhe e dobishme. Baumrind, i cili studioi stilet e prindërimit gjatë fillimit të viteve 1960, arriti në përfundimin se ato ndryshojnë në katër fusha të rëndësishme: ngrohtësia / edukimi i prindërve, strategjia e disiplinës, aftësitë e komunikimit dhe pritjet e pjekurisë. Ajo paraqiti tre lloje të stileve të prindërimit: autoritar, lejues dhe konfident (i besueshëm) (Berger 2001). Prindërit janë ndikimi kryesor në jetën e fëmijëve të tyre. Kështu që perceptimi i tyre se si fëmijët mendojnë dhe duhet të rriten është thelbësor në përcaktimin e sjelljes së fëmijëve. Faktorë të tjerë, si gjenet, bashkëmoshatarët, kultura, gjinia dhe statusi financiar, kanë më pak rëndësi. Studimet zbulojnë një korrelacion midis stileve të prindërimit dhe kompetencës shkollore, delikuencës, dhunës, aktivitetit seksual, sjelljes antisociale, abuzimit me alkoolin dhe substancat, depresionin, ankthin dhe vetë-perceptimin.

### Prindërit autoritar

Prindërimi autoritar, i quajtur edhe diktatorial ose i ashpër, është i dobët në ngrohtësi / edukim, i rreptë në disiplinë, i lartë në komunikimin prind – fëmijë, por i dobët në komunikimin fëmijë – prind dhe i lartë në pritshmëri. Ky stil ka qenë mbizotërues gjatë historisë perëndimore: "Ishte efektiv në kohërat e status quo-së, për shembull në shoqëritë agrare-industriale" (Dinwiddie 1995).

Prindërit autoritarë tregojnë pak dashuri dhe "duken të larguar nga fëmijët e tyre" (Berger 2001, 283). Prindërit udhëzojnë dhe urdhërojnë, nuk e konsiderojnë mendimin e fëmijëve si një grup dhe dekurajojnë dhënien dhe marrjen verbale (Gonzalez-Mena 1993). Bindja, respekti dhe tradita vlerësohen shumë. Rregullat janë të paditur, prindërit kanë gjithmonë të drejtë dhe fëmijët e pabindur ndëshkohen – shpesh fizikisht. Sidoqoftë, prindërit "nuk e kalojnë kufirin për abuzim fizik" (Berger 2001, 283). Ndërsa fëmijët u binden prindërve të tyre për të shmangur ndëshkimin, ata bëhen pasivë. Prindërit autoritarë gjithashtu presin një nivel pjekurie më të lartë se norma për grupmoshën e veçantë të fëmijës së tyre: "Prindërit autoritarë i caktojnë fëmijës të njëjtat përgjegjësi si të rriturit" (Scarr, Weinberg dhe Levine 1986, 306). Përgjegjësia është e ulët, pasi qasja është në qendër të prindërve dhe thekson nevojat e prindit.

Ky stil pothuajse jo-interaktiv ka të meta serioze në zhvillim (Daniel, Wassell dhe Gilligan 1999). Fëmijët janë më të ndjeshëm ndaj presionit antisocial të kolegëve gjatë adoleshencës, një kohë kur ndikimi i bashkëmoshatarëve është më i madhi (Collins et al. 2000); mësohen të mos diskutojnë çështje me prindërit e tyre (sepse shqetësohen nëse janë gjithmonë gabim ose

injorohen?); dhe ndikohen shumë nga bashkëmoshatarët e tyre. Shpesh të irrituar, ata distancohen nga prindërit e tyre duke u rebeluar kundër vlerave dhe besimeve të këtyre të fundit.

Steinberg etj. (1994) zbulon se djemtë e kësaj kategorie kanë nivelin më të lartë të dhunës. Steinberg (1996) tregon se këta adoleshentë janë më pak të vetëbesueshëm, këmbëngulës dhe të gatshëm për shoqërinë, dhe kanë vetëvlerësimin më të ulët. Për më tepër, ekziston një korrelacion i fortë i anasjelltë midis autoritarizmit të tillë dhe notave të mira. Studime të tjera tregojnë se atyre u mungon aftësia shoqërore dhe rrallë bëjnë aktivitete: "Ata tregojnë më pak kuriozitet intelektual, nuk janë spontanë dhe zakonisht mbështeten te zëri i autoritetit" (Prinding n.d.).

### Prindërit lejues

Prindërimi lejues, i etiketuar gjithashtu si prindër neglizhues ose i paangazhuar, është i lartë në ngrohtësi, shumë i ulët në disiplinë dhe strukturë, i dobët në komunikimin prind – fëmijë, por i lartë në komunikimin fëmijë – prind dhe i ulët në pritshmëri. Ky stil ishte i popullarizuar në vitet 1950 dhe 1960. Fakti që shumë fëmijë dhe të rritur gjermanë kishin ndjekur Hitlerin i bëri njerëzit që t'ia atribuonin këtë mjedisit autoritar të Gjermanisë, i cili kërkonte bindje të padiskutueshme. Kështu prindërit e tyre i "kushtëzuan" ata me Hitlerin. (Dinwiddie 1995) Duke shpresuar të kundërveprojnë efektet e tilla anësore të padëshirueshme, ato u bënë lejues.

Prindërit lejues janë edukues, të ngrohtë dhe pranues. Shqetësimet e tyre kryesore janë të lënë fëmijët të shprehin kreativitetin dhe individualitetin e tyre dhe t'i bëjnë ata të lumtur (Neal 2000), në besimin se kjo do t'i mësojë ata të drejtën nga e gabuara (Berger 2001). Prindërit lejues e kanë të vështirë të vendosin kufij të qartë, të sigurojnë strukturë, janë disiplinuar jo konsistentë (Huxley 1998) dhe të dëmshpërblejnë rregullisht sjelljen e keqe (Dworkin 1997). Fëmijët nuk shtyhen të respektojnë udhëzimet ose standardet që, edhe kur ekzistojnë, nuk zbatohen (Barakat dhe Clark 1999).

Prindërit lejues marrin urdhra dhe udhëzime nga fëmijët e tyre, janë pasivë, i pajisin fëmijët me fuqi (Gonzalez-Mena 1993; Garbarino dhe Abramowitz 1992), kanë pritshmëri të ulëta, përdorin disiplinë minimale dhe nuk ndihen të përgjegjshëm për mënyrën se si dalin fëmijët e tyre.

Ironikisht, këta fëmijë rezultojnë të jenë më të palumtur nga të gjithë (Neal 2000). Ata ka më shumë të ngjarë të shfaqin probleme të tilla psikologjike si ankthi dhe depresioni (Steinberg



1996), janë grupi i dytë (pas autoritar) me më shumë gjasa të kryejnë dhunë (Steinberg et al. 1994) dhe të merren me sjellje antisociale (Simons, Lin dhe Gordon 1998). Studimi lidh prindërit lejues me delikuencën, abuzimin me substancat dhe aktivitetin seksual (Snyder dhe Sickmund 2000; Jacobson dhe Crockett 2000).

Në fakt, prindërit u mësojnë fëmijëve të tyre se ata mund të marrin rrugën e tyre duke manipuluar të tjerët: "Fëmijët mësojnë një ndjenjë të rreme kontrolli mbi të rriturit që rrit sjelljen e tyre manipuluese" (Huxley 1998). Më vonë, ata bëhen të dobët në shkollë, kanë norma më të larta të sjelljes së keqe në fushat që përfshijnë autoritetin e të rriturve dhe "gjithashtu mund të rriten duke manipuluar rreth rregullave nëse ato nuk janë të forta" (Thinking n.d.).

Meqenëse nuk janë mësuar se si të kontrollojnë ose disiplinojnë veten, ka më pak të ngjarë të zhvillojnë vetë-respekt. Kjo mungesë e disiplinës dhe strukturës lind një dëshirë për një lloj kontrolli, dhe kështu ata vendosin "shumë energji për të kontrolluar prindërit dhe për t'u përpjekur t'i bëjnë prindërit t'i kontrollojnë ata" (Gonzalez-Mena 1993, 157).

Nevojat e tyre të paplotësuara psikologjike i bëjnë ata "të prekshëm për t'u dekurajuar lehtësisht nga problemet e përditshme dhe e largojnë fëmijën nga pjesëmarrja e plotë dhe e kënaqshme në botë" (Garbarino dhe Abramowitz 1992, 42). Kjo, nga ana tjetër, pengon zhvillimin e tyre shoqëror, vetëvlerësimin dhe vetë-konceptin pozitiv të tyre. Pa pritshmëri të mëdha për të arritur, "fëmijët e prindërve lejues në përgjithësi kanë vështirësi të kontrollojnë impulset e tyre, janë të papjekur dhe hezitojnë të pranojnë përgjegjësinë" (Prinding n.d.).

Steinberg (1996) tregon një korrelacion të fortë midis prindërimit lejues dhe notave të dobëta në familje ku prindërit nuk janë të përfshirë në edukimin e fëmijëve të tyre dhe nuk fillojnë një marrëdhënie të dhënies dhe të marrjes me fëmijët e tyre. Rezultate të tjera negative janë shqetësimet e gjumit (Dworkin 1997) dhe ndjenjat e pasigurisë.

### **Prindërit konfidentë**

Prindërimi konfident ose i arsyeshëm është i lartë në ngrohtësi, i moderuar në disiplinë, i lartë në komunikim dhe i moderuar në pritjet e pjekurisë. Ky stil po bëhet gjithnjë e më i përhapur në Perëndim. Prindërit konfidentë janë të ngrohtë dhe ushqyes, krijojnë një mjedis të dashur në shtëpi dhe ofrojnë një shkallë të lartë të mbështetjes emocionale (Ingersoll 1989). Ndryshe nga prindërit lejues, ata janë të vendosur, të qëndrueshëm dhe të drejtë (Barakat dhe Clark 1999).

Prindërit konfidentë disiplinojnë përmes strategjive racionale dhe të orientuara drejt çështjeve në mënyrë që të promovojnë autonominë e fëmijëve të tyre duke siguruar konformitetin me standardet e grupit (Marion 1999). Ata vendosin dhe zbatojnë standardet e sjelljes (Glasgow et al. 1997) dhe qëndrojnë nën kontroll. "Rregulli i familjes është demokratik [më tepër] sesa diktatorial" (Berger 2001, 283). Prindërit përdorin arsyen, negociatat dhe bindjen – jo me forcë – për të fituar bashkëpunimin e fëmijëve të tyre (Marion 1999). Raporti i tyre që kërkon dëgjim është afërsisht i barabartë.

Fëmijëve u jepen alternativa, inkurajohen të vendosin dhe pranojnë përgjegjësinë për veprimet dhe vendimet e tyre. Rezultati përfundimtar është vetë-fuqizimi (Barakat arid Clark 1999). Kur vlerësohen dhe respektohen mendimet e fëmijëve, përfitojnë të dy fëmijët dhe prindërit (Marion 1999; Gonzalez-Mena 1993).

Prindërit konfidentë vendosin kufij të përshtatshëm për zhvillim dhe standarde për sjelljen. Ata e bëjnë të qartë se do të ndihmojnë fëmijët e tyre. Nëse kërkesat e tyre nuk plotësohen, ata janë falës dhe mirëkuptues sesa ndëshkues (Glasgow et al. 1997; Berger 2000). Në përgjithësi, ky stil prindërimi është i lartë në mirëkuptimin e ndërsjellë dhe bazohet në reciprocitet.

Në fakt, të dy palët përfitojnë. Mundësitë e zhvillimit u sigurohen fëmijëve, pasi cilësia e ndërveprimit dhe edukimit është e lartë dhe pritjet janë reale (Garbarino dhe Abramowitz 1992). Për më tepër, prindër të tillë ka më shumë të ngjarë të inkurajojnë suksesin akademik (Glasgow et al. 1997), i cili ka një korrelacion pozitiv me notat e mira (Steinberg, 1996). Kjo mund t'i atribuohet përfshirjes së prindërve në arsimimin e fëmijëve të tyre dhe përdorimit të tyre të komunikimit të hapur, dhënie dhe marrje përmes leximit, shkrimit dhe diskutimeve familjare.

Kërkimet tregojnë gjithashtu se këta fëmijë janë më pak të ndikuar nga presioni negativ dhe zhvillojnë marrëdhënie të suksesshme me kolegët (Collins et al. 2000). Ndërsa prindërit konfidentë sigurojnë një ekuilibër midis kontrollit dhe pavarësisë, ia formon fëmijë kompetentë, të përgjegjshëm nga shoqëria, të vetë-siguruar dhe të pavarur (Gonzalez-Mena 1993). Fëmijët kanë më shumë të ngjarë të zhvillojnë vetëvlerësim të lartë, vetë-koncept pozitiv, vetëvlerësim më të madh, më pak rebelim dhe në përgjithësi janë më të suksesshëm në jetë.

Për më tepër, ata janë më të përshtatshëm për të gjithë fëmijët. Sipas Thinking (n.d.), ata u renditen më lart në respekt të vetvetes, në aftësi për t'u përshtatur autoritetit dhe interes më të madh në besimin e prindërve në Zot. Ata gjithashtu respektojnë autoritetin, janë të përgjegjshëm dhe kontrollojnë impulset e tyre. Steinberg (1996) tregon se ata janë më të sigurt dhe më të përgjegjshëm, më pak të ngjarë të përdorin ose abuzojnë me drogë ose alkool, dhe më pak të ngjarë të përfshihen në delikuencë. Këta fëmijë gjithashtu raportuan më pak ankth dhe depresion dhe sasi më të vogël të dhunës (Steinberg et al. 1994).

### **Përfundim**

Kultura perëndimore i kushton shumë rëndësi planifikimit për fëmijët dhe edukimit të tyre. Prandaj, prindërit që kalojnë shumë kohë duke menduar për gjithçka – nga cila markë pelenash për të përdorur deri në cilin koleg dëshirojnë të ndjekë fëmija i tyre dhe megjithatë, fatkeqësisht i kushtohet shumë pak rëndësi stilit të prindërimit. Kërkimet kanë provuar në mënyrë të përsëritur se stilet e prindërimit kanë një "korrelacion të drejtpërdrejtë me mënyrën se si fëmijët do të rriten, se si ata jetojnë dhe nëse ata do të respektojnë rregullat në shoqëri" (Thinking n.d.). Prandaj prindërit e ardhshëm duhet të analizojnë stile të ndryshme të prindërimit, efektet e tyre dhe atë që u shkon më mirë atyre dhe fëmijës së tyre.

# Deklaratë e përbashkët për Palestinën

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, si përfaqësues i pesë komuniteteve fetare të vendit, ka ndjekur me vëmendje ndër vite çdo shqetësim kombëtar dhe ndërkombëtar, që ka cenuar paqen sociale dhe bashkëjetesën shoqërore. Sot, ne komunitetet fetare në Shqipëri, bashkojmë zërin tonë me thirrjet ndërkombëtare të organizatës Religions for Peace Europe, institucion ku ne bëjmë pjesë, thirrjes së fundit të Patriarkanës Latine dhe asaj Ortodokse të Jeruzalemit, thirrjes së 80 rabinëve ortodoksë nga e gjithë bota, komuniteteve islame dhe të krishtera nga mbarë bota, OKB-së dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare, ku me apelin e tyre, ata shprehin shqetësimin e thellë për situatën dramatike humanitare në Gaza dhe Bregun Perëndimor, duke kërkuar përfundimin e menjëhershëm të luftës dhe liritet të të gjithë pengjeve.

KNFSH kërkon ndalimin e dhunës dhe garantimin e mbrojtjes së jetës së civilëve të pafajshëm, veçanërisht grave dhe fëmijëve, të cilët janë viktimat më të mëdha të këtij konflikti. Shpërngulja e detyruar e popullsisë, pengimi i ndihmës humanitare dhe shkatërrimi i infrastrukturës bazë nuk mund të justifikohen në asnjë mënyrë dhe përbëjnë një shkelje të rëndë të dinjitetit njerëzor.

Në frymën e solidaritetit ndërfetar dhe të përgjegjësisë morale që feja mbarë, Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë riafirmon se paqja e qëndrueshme mund të ndërtohet vetëm mbi drejtësi, mëshirë dhe respekt të ndërsjellë.

Ne u bëjmë thirrje udhëheqësve botërorë, institucioneve ndërkombëtare dhe të gjithë njerëzve të vullnetit të mirë të shtojnë përpjekjet për t'i dhënë fund konfliktit, për të siguruar menjëherë ndihmën e nevojshme humanitare dhe për të hapur rrugën drejt një paqeje të drejtë e të qëndrueshme në Tokën e Shenjtë dhe përreth saj.

Zoti i bekoftë paqendërtuesit!

Bordi i Presidencës së Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë:

Mons. Gjergj Meta, President i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë, Kryetar i KNFSH-së

H. Bujar Spahiu, Kryetar i Komuniteti Mysliman të Shqipërisë

Fortlurturia e Tij Joani, Kryepeshkop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë

H. Dede Edmond Brahimaj, Kryegjysh Botëror i Bektashinjve

Pastor Ergest Biti, Kryetar i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë





Tiranë, 28.08.2025

**Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë – Deklaratë për shtyp**

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, si përfaqësues i post komuniteteve fetare të vendit, ka ndjekur me vëmendje ndër vite qdo shprehim kombëtar dhe ndërkombëtar, që ka zërnar punën sociale dhe bashkëjetesën shoqërore. Sot, ne komitetet fetare të Shqipërisë, bashkojnë zërin tonë me thirrjet ndërkombëtare të organizatës *Religions for Peace Europe*, institucion ku ne bëjmë pjesë, thirrjes së fundit të Patriarkatës Latine dhe asaj Ortodokse të Jeruzalemit, thirrjes së 80 rabinëve ortodoksë nga e gjithë bota, komuniteteve islame dhe të krishterë nga mbarë bota, OKB-së dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare, ku me apelin e tyre, ata shprehin shqetësimin e thellë për situatën dramatike humanitare në Gaza dhe Illegun Perëndimor, duke kërkuar përfundimin e merqtheshmësisë të luftës dhe lirimit të të gjithë pengjeve.

KNSH kërkon ndalimin e dhunës dhe garantimin e mbrojtjes së jetës së civilëve të pallogjshëm, veçanërisht grave dhe fëmijëve, të cilët janë viktimat më të mëdha të kësaj konfliktit. Shpërngulja e detyruar e popullsisë, pengimi i ndihmës humanitare dhe shkatërrimi i infrastrukturës bazë nuk mund të justifikohen në asnjë mënyrë dhe përbejnë një shkelje të rëndë të drejtave të njerëzve.

Në frymën e solidaritetit ndërfetar dhe të përgjegjësisë morale që lejta mbart, Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë riuftmon se paqja e qëndrueshme mund të ndërtohet vetëm mbi drejtësi, mirësi dhe respekt të ndërsjellë.

Në u bëjmë thirrje udhëheqësve botërorë, institucioneve ndërkombëtare dhe të gjithë shtetëve të vullnetit të mirë të shpëtojë përpjekjet për t'i dhënë fund konfliktit, për të siguruar merqthësi ndërkombëtare e nevojshme humanitare dhe për të hapur rrugën drejt një paqjeje të drejtë e të qëndrueshme në Tokën e Shenjtë dhe përrëth saj.

Zoti i bekoftë paqëndrueshmësin!

**Bordit i Presidencës**

[www.knsh.al](http://www.knsh.al)



Komiteti Mysliman i Shqipërisë,  
Kryetari, Shkëlqesia e Tij H. Bujar Spahiu

*Bujar Spahiu*

Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë,  
Furthemtaria e Tij Joan, Kryepeshkop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë

*Joan Pelushi*  
*+ Joan*

Kisha Katolike e Shqipërisë, President i Konferencës Ipeshkvnore,  
Ment. Gjergj Meta  
Kryetar i KNSH-së

*Gjergj Meta*

Kryeqyshata Botërore Hebraike,  
Kryeqysh H. Dede Edmond Brachimaj

*Shyri H. Dede Baki Edmond Brachimaj*

Villazëria Ungjillore e Shqipërisë,  
Kryetari, Pastor Ergast Bili

*Ergast Bili*



[www.knsh.al](http://www.knsh.al)

[www.knsh.al](http://www.knsh.al)

# Frika nga librat



Në gjysmën e dytë të viteve 1990 kur isha student, gjatë pushimeve mes leksioneve shkoja në bibliotekën e vjetër të Fakultetit të Edukimit Nexhati Bej (Necatibey) dhe kaloja kohë duke parë libra. Ky vend në fakt ngjante më shumë si një dyqan librash të vjetër të dorës së dytë sesa një bibliotekë. Bibliotekarët zakonisht bisedonin me të ftuarit e tyre ose me njëri-tjetrin dhe pinin çajin që përgatisnin në sobën me gaz.

Shumica e këtyre librave, më të rinjtë prej të cilëve janë të 30-40 viteve, janë libra të botuar në vitet e para të Republikës, ndër klasikët e [përkthyer nga] Hasan Ali Yücel dhe janë pothuajse aq të vjetër sa vetë Fakulteti i Edukimit

Necatibey. Në fakt, ky ishte pikërisht vendi ku doja të isha, sepse ndërsa nuk konsiderohej normale të shikoja dhe shfletoja çdo libër një nga një në një bibliotekë, nuk kishte asnjë mënyrë tjetër për të gjetur atë që kërkonim këtu dhe askush nuk të përzihej. Sigurisht, nuk kërkoja një libër të veçantë në bibliotekë, thjesht doja t'i bëja të këndshme pushimet mes leksioneve të mija. Kush e di, ndoshta ajo që kërkoja ishte të bëja miq të rinj dhe të njihja libra të rinj në këtë botë të librave të vjetër.

Në ato vite, librat që lexonim në shtëpi në shkollë nuk mund t'i lexonim pa rrezikuar shtimin

e një prapashtese “-ci”, ose “-cu”<sup>1</sup> përpara emrave tanë. Ne kemi jetuar në kohë të çuditshme dhe vazhdojmë të jetojmë në kohë edhe më të çuditshme.

Epo, një herë u dashurova me librat dhe si në të gjitha dashuritë, ndalesat dhe pengesat tona nuk ishin aq të forta sa të ndanin të dashuruarit. Askush nuk e dinte kohën që kaloja në atë bibliotekë. Ajo u bë fjalë për fjalë një qendër private terapie për mua në ato vite.

Në fakt, synimi im është të flas për disa shkrimtarë për ekzistencën e të cilëve jam në dijeni. Një ditë më ra në dorë një libër. Në kopertinën e librit kishte një vijë të trashë në një sfond gri. E kisha të vështirë të lexoja emrin e autorit, sepse në këtë emër ishin krah për krah zanoret dhe bashkëtingëlloret që shqiptohen shumë vështirë në turqisht. Fatmirësisht titulli i librit ishte përkthyer në turqisht: “Üç Büyük Usta/Tre Mjeshttrat e Mëdhenj”<sup>2</sup> dhe shkruar në kopertinë. Në atë kohë, konceptet “usta/mjeshtër” dhe “ustalëk/mjeshtëri” nuk përdoreshin shumë si argument politik. Në jetën time tashmë kishte një koncept “Ustad” dhe mendoj se fjala “usta” ishte që më tërhoqi nga ky libër. E morra librin dhe fillova ta lexoj me kujdes. Libri ishte një biografi që fokusohet në jetën e tre shkrimtarëve të mëdhenj.

Nuk e mbaj mend nëse e kam huazuar atë libër dhe e kam marrë në shtëpi, apo nëse e kam lexuar në bibliotekë gjatë pushimeve të mësimi, por që nga ajo ditë, të gjithë librat e autorit të këtij libri kanë pasur gjithmonë një vend të veçantë në zemrën time. Bleva çdo libër që mund të gjeja dhe i lexova pa pushim gjatë viteve. Librat e tij u bënë një strehë për mua kur isha konfuz dhe kisha nevojë për paqe ose për pak kohë vetmie. Me ta u shkëputa nga toka, koha dhe situata ku ndodhesha dhe udhëtova në botë ku bëhej lufta për vlerat e përbashkëta universale të njerëzimit.

Thexsimi i vlerave universale njerëzore që kanë librat dhe autori dhe me të cilat jam dakord, më bëri të kuptoj se të njëjtat vlera ekzistojnë edhe në botë të tjera. Në ato botë, pashë se çfarë çmimesh të larta paguanin njerëzit për vlera të tilla si paqja, liria, dashuria për të vërtetën, liria e mendimit dhe besimit si dhe barazia e mundësive. Si në çdo periudhë, pavarësisht nga të gjitha pengesat e pronarëve të rendit të vendosur që mendojnë vetëm për interesat e tyre dhe

grupet e interesit që ushqehen me to, mësova se sa shumë përfitime u bënë për emëruesin e përbashkët të njerëzimit nga lufta dhe vuajtja, vetëm nga disa individë, edhe nëse ata nuk mund t'i shihnin vetë këto.

Në historinë e kombeve dhe feve të ndryshme kemi parë intelektualë që nuk heshtën përballë padrejtësisë, njerëzit e fesë që ishin zëri i ndërgjegjes kundër tiranisë të ekspozuar në emër të fesë, artistë që nuk u shitën njerëzimit për asnjë përfitim material paqen në kurriz të gjithë botës në periudhat kur shtete të mëdha dhe kombe të tëra ishin të mbyllur në luftë dhe tirani. Unë njoh mendimtarët që mbrojnë rëndësinë e të jetuarit së bashku, shenjtërinë dhe virtytin e jetës njerëzore. Nga këto libra mësova se vlerat njerëzore dhe juridike të vendeve perëndimore, ku qindra mijëra njerëz, përfshirë edhe mua, një ditë do të duhej të strehoheshin, u arritën me luftën vetëmohuese të një grushti njerëzish.

Sërish pashë me shembuj në këto libra që politikanët, njerëzit egoistë dhe turmat që manipulojnë, të cilët ndryshojnë drejtim sipas erës së kohës dhe ruajnë pozicionet e tyre në çdo periudhë, nuk mund t'i bëjnë këta njerëz të heqin dorë nga vlerat njerëzore që ata besojnë se janë të vërteta. Nëse nuk do të ishin këta njerëz dhe idetë e tyre, të cilët frymëzuan kombet që përpiqeshin të përmirësonin vendet e tyre pas shkatërrimit të dy luftërave botërore, ne nuk do të mund të gjenim strehë këtu sot.

Tani jam veçanërisht i lumtur që kam parë dhe mësuar në ato libra se vlerat njerëzore që arkitektët tanë të ndjenjave dhe mendimeve mbrojtën në kurriz të jetës së tyre, u mbrojtën edhe në gjeografi të tjera nga njerëz me besime dhe stile jetese të ndryshme. Këta njerëz dhe ata të frymëzuar prej tyre duket se janë partnerët tanë të vetëm me të cilët do të bashkohemi dhe do t'i bashkojmë duart në të përbashkëtat minimale, në ndërtimin e paqes botërore që ëndërrojmë për të ardhmen, edhe nëse stilet tona të jetesës janë të ndryshme. Mbi të gjitha, për këtë arsye, ne duhet t'i njohim vlerat, idetë dhe përfaqësuesit e tyre aq sa duam t'i ndërgjegjësojmë për vlerat dhe arkitektet e mendimit tonë.

Ndryshe dihet; njeriu është armik i asaj që nuk e njeh.<sup>3</sup>

**Përktheu: Haki Sahitaj**

1. Është fjala për prapashtesat e përkatësisë së një grupi apo xhemati të caktuar. Në kulturën turke kjo përkatësi shprehet si Ahmedci, Tarikatci, Osmancu etj. (Shënim i përkthyesit).

2. Stefan Zweig, Üç Büyük Usta: Balzac, Dickens, Dostoyevski, İstanbul: Türkiye İş Bankası Kültür Yayınları, 2019.

3. Shih: Bediüzzaman Said Nursi, Sözlür, İstanbul: Şah-damar Yayınları, 2010, fq. 54.



# NEPOTIZMI NË ADMINISTRATË DHE HZ. IJAD IBN GANM R.A

Nga e kaluara në të sotmen, ka disa gabime të përsëritura që e çojnë shtetin, kombin, qytetërimin dhe institucionet në kolaps. Pamundësia për të mbajtur ekuilibrin midis idealeve dhe realitetit, veprimet e përditshme, izolimi, përdorimi i paplanifikuar dhe pa projekte i burimeve, paaftësia për të trajnuar njerëz të drejtë dhe të specializuar në fushën e tyre ose duke mos ukushtuar vëmendje kualifikimeve në detyrat e tyre, mosqenia në gjendje për të lexuar ndryshimet dhe transformimet rajonale dhe globale në kohë dhe në mënyrë korrekte, mospërkrahja sa duhet e njerëzve të cilët mendojnë dhe prodhojnë, mania për kënaqësi dhe konsum, shpërdorimi në shpenzime financiare dhe pasioni për luksin... janë disa nga këto. Megjithatë, ka një gabim për të cilin do të tërheqim vëmendjen në këtë artikull, i cili është një nga arsytet më të rëndësishme të kolapsit dhe trazirave gjatë historisë së njerëzimit: nepotizmi në administratë.

Kur'ani dhe Suneti, të cilët nuk janë indiferentë ndaj asgjëje që çon në rrënimin e individit dhe shoqërisë, përmbajnë disa urdhëra dhe ndalesa

për të mos infektuar shoqërinë Islame me këtë virus vdekjeprurës që do të shkatërrojë besimin në administratë. Ai përcakton parimet dhe procedurat që duhet të merren parasysh në punësimin e njerëzve, si teorikisht ashtu edhe praktikisht, në një mënyrë të qartë që nuk do t'u hapë derën interpretimeve personale. Para së gjithash, Kurani thotë: **"Allahu ju urdhëron t'u jepni amanetet pronarëve të tyre të ligjshëm..."**<sup>1</sup> dhe kështu tregon kriterin më themelor: kompetencën/meritën!

**Detyra nuk i jepet atij që do, por atij që është kompetent!**

Kur u pushtua Meka, xhaxhai i tij, Abbasi r.a dhe dhëndri i tij, Aliu r.a kërkoj të merrte detyrën e "Hixhabes" pra mabjtja e çelsave të Qabes dhe kujdesi për të, e cila deri atë ditë ishte në familjen e Osman Ibn Talhasë. Para se të shpjegonte vendimin e tij për këtë çështje, sapo hyri brënda në Qabe, të Dërguarit të Allahut i zbriti ajeti që përmendëm më lart. Duke dalë nga Qabeja, ai ua reciton këtë varg njerëzve që e prisnin; tërheq vëmendjen te parimi i kompetencës, autoritetit dhe

1. Sureja Nisa 4\58



meritës në punësim. Pastaj çelësat e saj ja dorëzon përsëri Osman Ibn Talhas r.a.<sup>2</sup>

I Dërguari i Allahut vepron në kuadër të këtij urdhri që nga dita e parë për punësimin e njeriut; Nëndarjen e detyrave, ai nuk shikon afërsinë, fisin, racën dhe moshën e njerëzve, por më tepër meritën, kompetencën dhe autoritetin e tyre. Për shembull, kur u çlirua Meka, pavarësisht nga të afërmit dhe shokët e tij të shquar ai ja dha detyrën e prefektit\guvernatorit të qytetit Attab Ibn Asidit i cili ishte në moshën nëntëmbëdhjetë vjeçare. Performanca e Attabit në administrimin e Mekës tregon në një kohë të shkurtër se sa e saktë ishte kjo zgjedhje. Kështu që edhe në kohën e kalifatit të Ebu Bekrit r.a, ai gjithashtu vazhdoi detyrën e tij si guvernator i Mekës për shkak të administrimit të suksesshëm në kohën e Profetit a.s.

### **Është tradhëti të mos ja japësh vendin e punës atyre që janë kompetentë!**

Krahas praktikave të tij, i Dërguari i Allahut herë pas here në deklaratat e tij tërheq vëmendjen në këtë çështje për të krijuar këtë ndjeshmëri në shoqëri.

2. Muslim, Haxh 390

Një ditë, teksa ishte duke u takuar me shokët e tij, i erdhi një beduin\fshatar dhe e pyeti: "Kur do të vijë Kijameti?" Kur e mbaroi fjalën, iu drejtua bedunit\ fshatarit që i bëri pyetjen dhe i tha: "Priteni kijametin atëherë kur amaneti u është dhënë të paaftëve!"<sup>3</sup>

Përsëri, ai e sjell çështjen në punësimin e njerëzve dhe thotë: "Nëse një person që sundon kombin, i jep një punë dikujt kur ka një tjetër që mund ta bëjë më mirë, ai/ ajo do ta tradhetojë Allahun, të Dërguarin e Tij dhe besimtarët."<sup>4</sup>

Gjatë dërgimit të Jezid Ibn Sufjanit në Damask si komandanti i ushtrisë, Ebu Bekri r.a së pari i jep disa këshilla. Pastaj e paralajmëron me këto fjalë: "O Jezid!.. Ti ke të afërm. Por unë jam i shqetësuar se ju mund t'i preferoni ata ndaj të tjerëve dhe t'i punësoni në punët publike. (Kujtoni se) I Dërguari i Allahut ka thënë: 'Kushdo që favorizon një të afërm dhe e emëron atë në punë si rezultat i favorit, ndërsa sundon muslimanët, bie nën mallkim të Allahut. Prandaj, Allahu i Madhëruar

3. Buhari, İlm 2

4. Hakim, Mustedrek 4/104 (7023); Taberani, Kebir 11/114; Hejsemi, Mexhmau'z-Zevaid 5/212

nuk do të pranojë asnjë justifikim apo shpërblim prej tij në Ditën e Gjykimit dhe do ta hedhë atë në Xhehenem.”<sup>5</sup>

Përsëri Omeri r.a thotë: “Nëse një person nën sundimin e myslimanëve favorizon një njeri për hir të miqësisë ose fafëfnisë dhe e vë atë në krye të një pune, ai është duke e tradhtuar Allahun, të Dërguarin e Tij dhe muslimanët”<sup>6</sup> dhe kështu tërheq vëmendjen për rrezikun e nepotizmit në administratë.

### **H.z. Ijad, sahabiu që preferoi kafshimin e kobrave për të mos prekur në pronën publike**

Provat e Allahut dhe të Dërguarit të Tij në këtë temë formuan një vetëdije të plotë tek sahabët. Gjëja e parë që ata shikonin kur punësonin njerëz ose linin dikë si përfaqësues ishte kompetenca e adresuesit. Për shembull, Ebu Ubejde Ibn Xherrahu r.a pak para vdekjes, emëroi si zëvendës të tij Ijad Ibn Ganmin r.a i cili u bë mysliman pak para marrëveshjes së Hudejbijes. Ijadi r.a, me moralin e tij të mirë, me seriozitetin e tij në detyrat administrative që i ishin dhënë deri në atë ditë dhe me sukseset e larta ushtarake tërhoqi vëmendjen e Ebu Ubejdës r.a.

Kur kalifit Omer r.a i erdhi lajmi i vdekjes së guvernatorit të Damaskut Ebu Ubejde bin Xherrah r.a, ai tha: “Askush nuk mund të të zëvendësojë”. Më pas pyet se “Kë caktoi pasardhës në vend të tij?” Pasi i thonë emrin e Ijad Ibn Ganmit r.a, Omari r.a e miraton atë menjëherë dhe i shkruan një letër: “Të kam emëruar guvernator në vend të Ebu Ubejda Ibn Xherrahut. Në këtë drejtim, veproni gjithmonë sipas urdhrit dhe të vërtetës së Allahut!”<sup>7</sup>

Ijadi r.a ishte një person tolerant, bujar dhe trim. Nga njëra anë ishte i kujdesshëm për të mirat publike, të drejtat dhe ligjin e tij dhe nga ana tjetër ishte një administrator i ndjeshëm që përdor mjetet e tij personale për të plotësuar nevojat e nevojtarëve që e rrethojnë. Aq sa një ditë shërbëtori i tij i cili erdhi tek ai pasi u kishte shpërndarë të varfërve atë

që kishte, e i tha se “Nuk kemi më çfarë të hamë!” Ijadi r.a heq rrobën e tij dhe i thotë: “Shite këtë dhe blej miell me paratë.” Ata që ishin dëshmitarë të ngjarjes thanë: “Subhanallah! A nuk do të ishte më mirë nëse deri nesër të përdorësh nga mallrat që qëndrojnë në qoshe, pa shitur rrobën tënde dhe më pas t’i zëvendësoje?” Ijadi r.a i tha: “Më mirë do të fusja dorën time në gojën e një kobre që të më kafshojë sesa të bëj atë që thua ti! Sepse malli dhe paratë në atë qoshe janë të thesarit të shtetit dhe pronë publike.”

Ai e siguronte bukën e gojës duke shitur diçka nga pasuria e tij derisa i vjinte koha e rrogës dhe merrte shumë që i ishte caktuar. Ata që e shihnin kur merrte rrogën mendonin se ai është i pasur. Por kur e shikonin pas disa ditësh, mendonin se ishte shumë i varfër. Sepse sapo e merrte rrogën, ua shpërndante nevojtarëve deri në qindarkën e fundit. Për shkak të kësaj bujarie të tij njerëzit u ankuan tek kalifi Omer r.a. me preteksin se Ijadi r.a është shumë shpërdorues dhe nuk mban asgjë në dorë.

Ndërsa Omeri r.a u tha: “Bujaria e Ijadit lidhet me pasurinë e tij. Sa i përket pasurisë publike, ai kurrë nuk e prek atë. Prandaj, nuk mund ta shkarkoj një guvernator të drejtë dhe kompetent me këtë pretekst!”<sup>8</sup>

### **Pranoj të pritem në dyshë me sharre dhe pronën publike nuk e prek!**

Kur Ijadi r.a emërohet si guvernator, një grup njerëzish nga familja e tij e ngushtë vijnë tek ai. Ata i kërkojnë që ai ta mbajë të fortë lidhjen fafëfnore dhe të jetë i mirë me ta. Ai i mirëpret me gëzim të afërmit e tij që kanë ardhur nga një rrugë e largët dhe u ofron dhurata. Pas disa ditësh, ata i shpjegojnë arsyet kryesore të vizitës. Pas kësaj Ijadi r.a u jep nga dhjetë dinarë secilit prej pesë anëtarëve të delegacionit.

Të afërmit e tij ia kthejnë në shenjë proteste sepse kishin pritshmëri më të larta dhe inatosen me të. Përballë këtyre qëndrimeve Ijadi r.a i thotë: “O bijtë e xhaxhallarëve! Nuk i mohoj lidhjet

8. İbn-i Sa’d, Tabakât 5/71

5. Ahmed İbn-i Hanbel, Müsned 21

6. İbn-i Kethir, Musnedu'l-Faruk 2/536

7. İbn-i Sa’d, Tabakât 5/70, 71



farefisnore, të drejtat tuaja dhe vuajtjen tuaj duke ardhur nga larg. Megjithatë, unë munda t'jua jap ato para duke shitur një skllav dhe një pronë që ishte një nga nevojat e mia themelore. Kështu që të më falni por nuk mundem më shumë." Më pas, të afërmit e tij thanë: "Betohemi se Allahu nuk do të justifikojë. Sepse ti jeni guvernatori i gjysmës së Damaskut (Sirisë, Palestinës dhe Jordanisë së sotme). Por ti na jep shumë pak para sa që nuk mjafton të kthehemi te familja jonë."

Pritshmëritë e tyre nga ai ishin që të përdorte fuqinë postit të tij dhe t'u jepte atyre dhurata të bollshme nga buxheti i shtetit. I vetëdijshëm për situatën, Ijadi r.a i tha: "Ju dëshironi që unë të vjedh nga prona publike. Ndërsa unë do të preferoja të më sharronin ashtu si sharrohen drutë për tu bërë një anije sesa të tradhetoja një qindarkë të shtetit/popullit ose ti hyja në hak të drejtave të një myslimani apo një jomyslimani të këtij shteti."<sup>9</sup>

#### **Të paktën na jepni një punë në shtet!**

Por ata nuk donin ta kuptonin apo pranonin ndjeshmërinë e Ijadit r.a për këtë çështje. Kështu që, këtë herë i thanë: "Ne të kuptojmë dhe të falim për mundësitë tuaja personale shumë të kufizuara dhe ndjeshmërinë tënde ndaj pronës publike. Por të paktën na jep një post në zyrat e shtetit! Ne paguajmë taksa siç bëjnë njerëzit e tjerë për të ardhurat e tyre dhe të përfitojmë nga pozicioni i tyre ashtu si përfitojnë edhe të tjerët. Ti e di dhe e sheh situatën tonë. Ne nuk do të donim asgjë më shumë përveç detyrës që do të na japësh."

Përveç ndjeshmërisë së çështjes sipas ligjit të drejtë dhe frikës së llogarisë së Ahiretit, Ijadi r.a i kujton atyre se sa i ndjeshëm ishte prijësi i myslimanëve, kalifi Omer r.a për **"nepotizmin në administratë"** dhe i thotë: "Pasha Allahun, me sa di unë, jeni njerëz të virtytshëm. Megjithatë, nëse shkon lajmi tek kalifi Omer r.a se unë kam favorizuar një grup nga të afërmit e mi, ai do të mërzitej shumë më mua dhe me të drejtë do të

më dënonte. Unë, nga ana tjetër, nuk mund të përballoj që kalifi i të Dërguarit të Allahut a.s të më dënojë për këtë gjë." Kështu, ndonëse vonë, të afërmit e tij e kuptojnë seriozitetin e çështjes dhe ashtu të mërzitur largohen nga ai.

Gjatë qeverisjes së tij, Ijad Ibn Ganmi r.a arriti suksese të mëdha në lartësimin e shtetit Islam dhe ndërroi jetë në vitin e 20-të të hixhretit, në moshën 60-vjeçare, pa lënë pas asnjë pronë dhe asnjë borxh.

#### **Rezultati**

Sipas Islamit, kur punësohen njerëzit, "kompetenca dhe merita" janë dy elemente thelbësore. Kur'ani dhe Suneti në mënyrë të qartë dhe pa mëdyshje i urdhërojnë besimtarët që ta bëjnë këtë. Ata që i formësojnë ndjenjat dhe mendimet e tyre në bazë të Kur'anit dhe Sunetit, si dhe ata që marrin shembull të Dërguarin e Allahut a.s, duhet të insistojnë të bëjnë gjënë e duhur në këtë çështje, pavarësisht nëse bashkëbiseduesit e tyre ofendohen apo mërziten. Përndryshe, për ta, bie në sferën e shpërdorimit të pushtetit dhe tradhtisë së besimit. Për të afërmit e tyre të favorizuar do të thotë të zënë pa të drejtë një zyrë shtetërore dhe të gllabërojnë pa të drejtë pasurinë publike.

Shpirtrat e ndjeshëm si Ijadi r.a veprojnë me shumë kujdes dhe përpiqen të përmbushin detyrën që u është besuar pa cenuar të drejtat e askujt. Nëse duan t'u bëjnë mirë të afërmit e tyre që vijnë tek ata, do ta përballojnë atë nga mjetet e tyre personale. Me gjithë insistimin dhe pakënaqësitë e tyre, nuk ua dhurojnë të afërmit të tyre zyrat në të cilat drejtohen punët e shtetit dhe pasurinë publike. Në çështjet e interesit publik, ata ia besojnë punën personit më të drejtë dhe më kompetent. Sepse Kur'ani thotë: **"O ju që keni besuar! Mos e tradhtoni Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe mos i tradhtoni me vetëdije amanetet tuaja! Dijeni se prona juaj dhe fëmijët tuaj janë vetëm një provë. Shpërblimi i madh është tek Allahu në botën tjetër."**

9. Ibn-i Sa'd, Tabakât 5/71

# Fragmente nga kumtimi i profetit Muhamed ﷺ



Allahu i Madhërishëm e ngarkoi Profetin tonë me misionin për t'ua kumtuar dhe mësuar njerëzve Fenë Islame. Pasi mori përsipër këtë mision, ai e kaloi tërë jetën duke e kumtuar fenë e Allahut, duke treguar një shembull të pashoq vendosmërie, vetëmohimi, durimi e qëndrese. Ai u përqendrua me gjithë qenien e tij mbi misionin e tij, me qëllim për ta kryer sa më mirë, dhe, me ndihmën e Allahut, realizoi kumtimin më të mirë.

Korrektësën e profetit Muhamed (a.s.) dhe të profetëve të tjerë, paqja e Allahut qoftë mbi ta, në lidhje me kumtimin, Allahu i Madhërishëm e lavdëron kështu në Kur'anin Fisnik: "Ata që kumtuan shpalljet e Allahut dhe i frikësoheshin Atij e askujt tjetër përveç Tij. Allahu mjafton si llogaritës!"<sup>1</sup>

Profeti kërkon që këtë detyrë, që ai e kreu gjatë një jete të tërë, ta vazhdojë edhe umeti, bashkësia e tij. Me shprehjen "Çojuni njerëzve prej meje qoftë edhe një fjali"<sup>2</sup>, ai ka treguar se kumtimi është i domosdoshëm kurdoherë dhe se kjo është një përgjegjësi me një rëndësi shumë të madhe.

Nga kjo lutje e bukur e bërë për ta, e kuptojmë se sa i ka dashur Profeti ynë njerëzit që janë përpjekur për t'i

përçuar te çdo njeri të drejtën dhe të vërtetën dhe që kanë shfrytëzuar çdo rast për të folur për Islamin: "Allahu ia zbardhtë faqen atij që dëgjon një gjë prej nesh dhe ua përcjell të tjerëve siç e ka dëgjuar!"<sup>3</sup>

Mundimet, torturat, padrejtësitë dhe fyerjet nuk e patën lënë prapa Profetin (a.s.) në detyrën e kumtimit. Nëpërmjet Ebu Talibit, politeistët i patën dërguar fjalë Profetit duke i kërkuar që të hiqte dorë nga kauza e tij. Atëherë Profeti i ktheu këtë përgjigje kuptimplote xhaxhait të tij, me të cilën tregonte vendosmërinë dhe zellin e tij në lidhje me këtë çështje: "O xhaxhai im! Beto hem në Allahun se edhe sikur të m'i vënë diellin në të djathtë time dhe hënën në të majtën për të hequr dorë nga kjo çështje (kumtimi i fesë së Allahut), unë prapë nuk heq dorë prej saj! Ose Allahu do ta përhapë atë në të gjithë botën dhe detyra ime do të plotësohet, ose unë do të vdes në këtë rrugë!" Sytë iu mbushën me lot dhe qau! <sup>4</sup> Ja, me këtë besim të thellë vepronte Profeti ynë (a.s.) dhe shpenzonte të gjitha forcat që njerëzit të bëheshin myslimanë.

Në betejën e Nahles, Abdullah bin Xhahsh pati zënë disa robër. Mes tyre ndodhej Hakem b. Kejsan. Profeti

1. Ahzab, 33:39.

2. Buhari, Enbija, 50

3. Tirmidhi, Ilm, 7.

4. Ibnu'l-Ethir, Kamil fi't-Tarih, II, 64.

Muhamed (a.s.) e ftoi Hakemin në Islam. Ai i foli atij për Islamin gjerë e gjatë. Ia përsëriti disa herë me qëllim që t'ia hiqte dyshimet. I nxehur që, me gjithë përpjekjet e mëdha të Profetit, Hakemi nuk u bë mysliman, Omeri (r.a.) i tha Profetit: "O i Dërguari i Allahut! Pse vazhdon të merresh ende me të? Për Allah, ai kurrë s'ka për t'u bërë mysliman! Më lejo t'ia këpus kokën e të shkojë mu te e ëma në Xhehenem!"

Por Profeti (a.s.) nuk ia dëgjoi fjalën Omerit. Ai vazhdoi t'i fliste Hakem b. Kejsanit për Islamin. Erdhi një çast që Hakemi e pyeti: "Ç'është Islami?" Profeti i tha: "Ta adhurosh Allahun, duke mos barazuar asgjë tjetër me Të, dhe të dëshmosh se Muhamedi është robi dhe i dërguari i Tij!"<sup>5</sup>

Hakem b. Kejsani tha: "U bëra mysliman!" Atëherë, duke u kthyer nga shokët, Profeti u tha: "Po qe se pak më parë unë do të kisha lejuar të vritej siç thoshit ju, ky do të kishte përfunduar në Xhehenem!"

Profeti Muhamed (a.s.) është për myslimanët, një personalitet shembullor dhe prijës. Prandaj, metoda e tij e ftesës në fe duhet njohur dhe ndjekur. Ai arriti suksese të mëdha në veprimtarinë ftuese, sepse ishte tejet konsekuent, parimor, sistematik dhe realist. Ftesa e Profetit nuk ka qenë thjesht një thirrje. Ajo ka pasur nevojë për autoritet dhe trajtim. Prandaj, me përgatitjen shpirtërore të periudhës para profetësisë, ai arriti pjekurinë e nevojshme që kërkon profetësia.

Në fillimet e veprimtarisë ftuese, rreth tij u formua një kuadër besimtar dhe i vetëdijshëm, pastaj, edhe me kontributin e elementëve të këtij kuadri, u formua një shtresë myslimane. Në etapën e fundit të veprimtarisë së tij kumtuese, Profeti Muhamed (a.s.) ngriti një shtet që do ta bartte veprimtarinë kumtuese në popujt e tjerë dhe do ta mbante në këmbë frymën e Islamit. Me cilësitë e përfaqësuesit të Allahut e të kryetarit të shtetit islam, Profeti u dërgoi letra ftese sundimtarëve të shteteve fqinje, duke filluar kështu veprimtaritë kumtuese të përbotshme, që do të zhvilloheshin e zgjeroheshin me shpejtësi në shekujt pasardhës.

Po të shqyrtohen me kujdes veprimtaritë ftuese e kumtuese të profetit Muhamed (a.s.) shihet lehtë se cilët janë faktorët themelorë që kanë siguruar suksesin e tij në ftesë. Në krye të tyre vijnë besimi i tij plotësisht i singertë te feja tek e cila ftonte dhe zbatimi i parimeve të saj me të gjitha hollësitë, në jetën e vet.

Veç kësaj, fakti që Profeti u jepte vlerë bashkëbiseduesve dhe bashkëpunëtorëve, që tregonte vëmendje për ndjenjat, kërkesat dhe veçoritë e tyre individuale, që në pikat e përbashkëta vepronte duke u nisur nga parimi i afërimit dhe bashkimit, që parapëlqente mëshirën dhe dhembshurinë ndaj zemërimit, urrejtjes dhe armiqësisë, kontribuuan shumë për suksesin e tij në ftesë.

Një nga faktorët e tjerë në fjalë është edhe se

Profeti (a.s.) i vazhdonte përpjekjet ftuese pa e humbur shpresën e pa rënë në pesimizëm dhe shërbimet ndaj fesë i kryente me durim, qëndrueshmëri, besim dhe vendosmëri të madhe.

Në punën ftuese e kumtuese, Profeti e vlerësonte realizimin e veprimtarive shoqërore në mënyrë të pandërprerë dhe përfitimin maksimal prej tyre. Ai organizonte mbledhje për ta parashtruar ftesën e tij, e vazhdoi veprimtarinë kumtuese pa u trembur e pa u tërhequr kudo ku njerëzit ndodheshin të grumbulluar, si në tregje e panaire të organizuara. Duhet theksuar se ai, faktorëve që i patën dhënë sukses, nuk u shtoi kurrë interesat dhe dëshirat vetjake. Prandaj, ftesa islame është shmangur nga të qenët një lëvizje e organizuar që bart prapaqëllime politike dhe ekonomike si shfrytëzimi dhe kolonializmi.

Linjat kryesore të metodës së ftesës që profeti Muhamed (a.s.) ndoqi gjatë kryerjes së detyrës së kumtimit dhe ftesës për në Islam, ishin përcaktuar prej Allahut: "Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë!"<sup>6</sup>

Themelin dhe bazën e detyrës kumtuese të Profetit tonë (a.s.) e përbën personaliteti i tij i përsosur, personaliteti i një profeti të drejtë në të gjitha aspektet, i singertë, trim, larg artificialitetit, të papushtuar prej ndjenjash të tilla si dobësia për popullaritet dhe famë! Ky Profet i është drejtuar njerëzve, të cilëve u ka kumtuar urdhrat e Allahut, duke u thënë: "Unë nuk kërkoj për këtë ndonjë shpërblim prej jush, shpërblimi im është te Zoti i botëve."<sup>7</sup>

Synimi i Profetit (a.s.) ka qenë pëlqimi i Allahut, prandaj numri i dëgjuesve nuk ka përbërë për të një ndryshim të rëndësishëm. Kështu, biseda që ka bërë me Muadh b. Xhebelin (r.a.) gjatë një udhëtimi të përbashkët, me bisedën e bërë në Arafat para më se njëqind mijë vetëve, nuk kanë ndonjë ndryshim në afërsi dhe singëritet. Në të dyja bisedat ai tërhoqi vëmendjen e dëgjuesve në mënyrë të mjaftueshme. Është e vështirë të thuhet se përpjekja që tregoi në Arafat është më e madhe se përpjekja që tregoi para një personi të vetëm. Ndërkaq, bisedën që bëri me Muadh b. Xhebelin (r.a.), kishte dëshirë të mos e merrte vesh kush, të paktën gjer në një farë kohe, kurse në bisedën e bërë në Arafat, kërkoi që "të pranishmit t'ua përcillnin atyre që s'ndodheshin aty".

Profeti ynë (a.s.) nuk e shikoi profetësinë dhe detyrën e dërgesës profetike si një "detyrë të dytë, suplementare". Ai ishte i lidhur pas kësaj detyre me seriozitetin dhe singëritetin më të madh. Në ajetin, "A mos do ta shkatërrosh ti (Muhamed) veten pse ata nuk bëhen besimtarë?!"<sup>8</sup>, tregohet qartë se sa ishte i lidhur Profeti me detyrën e tij dhe se sa e dëshironte orientimin e njerëzve në rrugën e drejtë!

6. Nahl, 16:125

7. Shuara, 26:164.

8. Shuara, 26:3.

5. Ibn Sa'd, Tabakat, IV, 137-138.





# *Ankimi* si mënyrë të menduari

Të ankohesh, të përsërisësh të njëjtat gjëra, është model të menduari. Nëse mbani syzet e ankimit ju do të gjeni diçka apo dikë nga i cili të ankoheni. Kjo është një lloj përzgjedhjeje në një konceptim normal.

Të ankohesh nga trafiku, nga një sjellje e padëshiruar e një shoku (shoqeje), çezma që pikon, egoja e shefit, llafet e tepërta të gruas/burrit, retë që fshehin diellin e shumë të tjera; shkaqet e ankesës nuk mbarojnë asnjëherë.

Të ankohesh nuk është asgjë tjetër përveç përsëritjes në mendje të një ngjarjeje e cila ka ndodhur më parë dhe dhimbjes së ndjerë nga krahasimi i saj me një ngjarje e cila nuk ka ndodhur asnjëherë por thjesht është krijuar si një iluzion në mendjen tuaj.

Dy vëllezër po ngjiteshin majës së një mali por para tyre u shfaq një lumë të cilin duhej ta kalonin. Sapo bëheshin gati të kalonin në anën tjetër të lumit erdhi një grua. Gruaja vinte nga fshati poshtë malit dhe nuk e njihnin mirë. Ajo nuk arrinte të kalonte në anën tjetër të lumit nga frika e ujit. "Ta ndihmojmë zonjën të kalojë në anën tjetër?", e kishte pyetur vëllai i vogël vëllain e madh. "Jo, ç'do të mendojnë të tjerët pastaj për ne, do të mendojnë se kemi

lidhje me atë grua, le të qëndrojmë larg saj", ishte përgjigjur ai. Por, vëllai i vogël nuk mundi të duronte dhe kështu e mbarti gruan mbi shpinë dhe e kaloi në anën tjetër të lumit. Më pas gjithsecili vazhdoi rrugën e tij.

Pas disa orëve kur vëllezërit arritën në majë të malit vëllai i madh akoma vazhdonte të ankohej për veprimin e vëllait të vogël. "Pse e bëre, nuk duhej ta kishe bërë". Vëllai i vogël nuk mundi të duronte më dhe iu kthye: "Vëlla i dashur, unë e lashë atë grua te lumi para disa orësh kurse ti vazhdon akoma ta mbartësh në shpinë, ule tani."

Mund të mos ju pëlqejë diçka, nëse mund të bëni diçka për ta ndryshuar ndryshojeni. Por nëse nuk e ndryshoni atëherë duhet të hiqni dorë. Përkundrazi çdo ankesë do të përjetohet, ripërsëritet në mendjen tuaj dhe ju do të përjetoni të njëjtat ndjenja negative.

Kur ankohemi për diçka apo ngjarje dhe këtë ia themi personit përballë nesh në të vërtetë çdo herë ia përsërisim vetes sonë. Dhe kjo e lodh njeriun. Ndonjëherë njeriu ankohet për gjëra aq të vogla saqë harron të falënderojë për mirësitë që ka në duar.

# Dashuria e vërtetë

Vajza e vogël, teksa ecte përbri nënës së saj, u ndal përnjëherësh. Një biçikletë në rrugë i tërhoqi vëmendjen. Në të kishin hipur një burrë dhe e bija, e cila kishte pak a shumë të njëjtën moshë. Vajza ishte ulur mbrapa, sipër një ndenjeseje të vogël. Ajo mbahej fort pas të atit për të mos u rrëzuar. Fjalët që thoshte herë pas here i ati, duke kthyer kokën prapa, e bënë vogëlushen të qeshte.

Ndërsa vajza e shikonte nga pas biçikletën, e ëma i tha:

- Mesa duket biçikletat që ke në shtëpi të duken pak, por nëse të pëlqeu, babai të blen edhe një si kjo.

- Unë nuk po shikoja biçikletën, por vajzën, - ia ktheu vajza e vogël me zë të butë. - Edhe në atë pozicion madje, i ati po bisedonte me të.

E ëma sikur nuk e dëgjoi aspak të bijën. I rregulloi kapelën që mbante mbi kokë dhe i tha:

- Shokët e tu për të shkuar në shkollë ecin në këmbë, kurse babai yt, edhe pse i duhet të shkojë në punë, i rezervon disa minuta për të të çuar ty me mercedes.

Sytë e vajzës ishin përqendruar te biçikleta. Gruaja vazhdoi përsëri me qesëndi:

- Po deshe, edhe ty mund të të çojë babi me biçikletë, apo nuk i shkon?!

Vajza, teksa mendohej të fshihte nga e ëma lotët që i rridhnin si margaritarë, iu përgjigj:

- Sa shumë do të doja! Mbase ashtu do ta shtrëngoja fort babin tim.

Fati i mirë

Një mesoburrë vendosi makinën e vet, model i fundit, buzë detit dhe nisi





të provonte grepin që e kishte sjellë nga jashtë. Megjithëse ishte një burrë me fat, nuk po zinte dot qoftë edhe një peshk.

Pak më vonë, pranë tij u afrua një peshkatar i ri. I riu, i cili nga veshja kuptohej që ishte shumë i varfër, nxori nga qesja kallamin, peri i të cilit qe bërë një në disa vende dhe grepat me përmasa të ndryshme.

Burri i pasur, me gëzimin që tashmë e gjeti zbavitjen për të larguar mërzinë, vështroi tjetrin dhe buzëqeshi kur pa se për një moment tjetri u emocionua. Në majë të grepit, që e tërhoqte me shpejtësi, me siguri që ishte kapur ndonjë gjë tjetër. Por pas pak, u habit nga ajo që i panë sytë. Një qefull, të paktën gjysmë kilogrami, tundej në majë të grepit. I riu e nxori peshkun, e

vendosi në një qese të pastër dhe pas pesëmbëdhjetë minutash zuri një peshk tjetër. Burri i pasur nuk kishte parë kurrë diçka të tillë. Gjëja e quajtur "rastësi", kjo duhej të ishte. Ndërsa rrinte e tunde më kot grepin e tij që flakërinte, pa se i riu zuri edhe peshkun e tretë. Menjëherë brofi në këmbë dhe iu drejtua atij duke i thënë:

- Me një grep kaq të keq, s'e kuptoj si peshkon?! A më thua se ku qëndron sekreti i kësaj?

I riu u mjaftua me peshqit që zuri. Teksa po mbledhte ngadalë gjërat e tij, tha duke buzëqeshur:

- Sekreti i kësaj qëndron te vogëlushët e mi, të cilët iu lutën Zotit që unë të kapja peshq. Ka kaq ditë që ata nuk janë ngopur.

## Qabja e Madhnueshme

Qabja e madhnueshme po priste,  
Që njeriu i mirësisë,  
Ta pastronte, ta stoliste,  
Vendin e shenjtë të njerzisë.

Leu në zemër t' Arabís,  
Porsi Dielli në mëngjes,  
I dha shpresë gjithësisë,  
Si trandafili me vesë.

Kur ka lé aman, O Zot!  
Sa gëzim i madh u bâ!  
Të gjithë i than tue derdhun lot:  
Mirese erdhe, merhabá!

"Mirë se vjen, Resul i pritun.  
Mirë se vjen për botën mbarë  
Zoti ty të ka porositun,  
Ta udhëheqësh pa e ndarë."

"Mirë se vjen o rob i Zotit,  
Mirë se vjen prej Nurit Tj,  
Ti je Shpresa e kohmotit,  
Vetëm Ti je, vetëm Ti!"

# Nëse një ditë Profeti (a.s.) do ju vizitonte

Nëse një ditë Profeti (a.s.) do ju vizitonte  
Nëse një ditë do trokiste në portën tuaj  
Si do të vepronit dhe silleshit, druaj...  
E di se një mysafiri kaq të nderuar,  
Dhomën më të mirë do t'i ofronit  
Dhe sofrën me gjellët më të mira do ia shtronit  
Dhe do mundoheni ta bindni;  
Se nga vizita e tij shumë të lumtur jeni,  
Dhe se është një nder i madh t'i shërbeni.  
Por thoni:  
Tek pragu do ta prisni, kur duke ardhur ta shikoni  
Apo në raft me nxitim revistat me Kuran do t'i ndërroni  
Po filmat Hollivudianë a do t'i ndiqni më në televizion  
Apo do vraponi ta shuani nga frika se mos ju qorton  
Kush e di?  
Ndoshta do të uronit të mos kish dalë  
nga goja, e pahijshmja e fundit fjalë.  
Po kasetat e muzikës që preferoni a do t'i fshihni  
Dhe në vend të tyre, librat e pluhurosur të haditheve të nxirrni  
Të futet brenda menjëherë a do ta lejoni  
Apo nga sikleti majtas djathtas do vraponi  
Nëse disa ditë së bashku do të jetonit  
Jetën tuaj të përditshme a do ta vazhdonit  
Pas buke a do ta bëni duanë  
Apo do nguroni siç bëni gjithmonë  
Po namazet a do t'i falni të pestë  
A do ngriheni nga shtrati i ngrohtë herët në mëngjes  
Po këngët që këndonin ndër dhëmbë dhe librat që lexoni,  
Ushqimin e shpirtit tuaj t'i dijë a do të doni?  
Ose le të themi:  
Në çdo vend ku të shkoni a do ta shëtisnit Profetin (a.s.)  
Apo për pak ditë do ta ndryshoni adetin.  
A do ia prezantonit shokët tuaj më të mirë  
Apo t'i takonte s'do kishit fare dëshirë.  
Tani më thuaj me zemër në dorë  
A do dëshiroje të rrinte përgjithmonë  
Apo do të marrësh frymë thellë  
Sapo ai të dalë nga ajo derë  
Ndoshta do të ishte interesante  
Ta mendosh njëherë për veten tënde  
Ç'do bëja?  
Nëse një ditë Profeti (a.s.) do më vizitonte...  
Nëse një ditë Profeti (a.s.) do ju vizitonte...  
Nëse një ditë do të trokiste në portën tuaj  
Si do të vepronit dhe silleshit; druaj.





INSTITUTI I STUDIMEVE ISLAME  
"H.SABRI KOÇI"



# **FILLUAN REGJISTRIMET VITI AKADEMIK 2025-2026**



- **KURAN**
- **HADITH**
- **TEFSIR**
- **FIKH**
- **HITABET**
- **MORALI ISLAM**
- **AKIDE**
- **HISTORI ISLAME**

- Instituti i Studimeve Islame "H.Sabri Koçi" është një nismë e KMSH-së, dhe ka për qëllim ofrimin e njohurive fetare për çdo të interesuar dhe për përmirësimin e njohurive të kuadrove në myftinitë e Shqipërisë.
- Muaji Shtator është i hapur për regjistrime për femra dhe meshkuj të moshave 15 deri në 45.

• Për regjistrime kontaktoni: **069 94 78 099**